

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7852 E hënë 15 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Nga KASTRIOT DERVISHI



Komunistët e vendosën yllin e kuq në flamurin kombëtar gjuhë në vitin 1944. Sigurisht, pa pasur asnjë vendim apo ligj. Për herë të parë, me miratimin ...  
Vijon në faqen 20

1992, si u hoq ylli i kuq sovjetik nga flamuri kombëtar dhe stema shtetërore

Opinion i Ditës

Nga FATOS ÇOÇOLI



Do protestoj në çdo orë të ditës dhe të natës. Do protestoj më shumë në mbremje ose natën, nëse duhet që kamerat e rrjeteve ndërkombëtare televizive të kapin ...  
Vijon në faqen 21

Protesta dhe policët e plagosur



Formula, e bazuar në vitet e punës dhe pagën referuese

## Pensionet e ushtarakëve, ja si bëhet përlogaritja

Kategoritë që përfitojnë dhe dokumentet që duhet të dorëzojnë

Të gjithë ata individë që kanë dhënë kontributin e tyre dhe kanë punuar si ushtarakë në disa prej disa institucioneve të përcaktuara në ligj, kanë të drejtën e përfitimit të pensionit suplementar. Në faqen zyrtare të Institutit të Sigurimeve Shoqërore theksohet se kategoritë që mund të marrin këtë pagesë janë ushtarakët e Forcave të Armatosura në ...  
Në faqen 8

KREU I PD, BASHA: JEMI KRAH NJEREZVE, S'KA KOMPROMIS ME ENDRREN TONE

# PROTESTA E OPOZITES, PRANGA 37 PERSONAVE

Urinoi te Kryeministria, bashkia gjobit PD-në me 20 mijë lekë, Rama: Ata prish e ne ndreq. Paloka: S'ka zgjedhje pa PD. Nëse ndodh, iki nga politika



(Në foto) Mbështetës të opozitës, duke u përplasur me policinë gjatë një proteste përpara Kryeministries

Në faqen 2-5

NE LISTE, 22 PARTI

Opozita, një javë për regjistrimin në zgjedhjet lokale të 30 qershorit

Në faqen 6

MEDIA GJERMANE

Bojkoti i opozitës, Gjermania: Do t'i vëzhgojmë në zgjedhjet vendore

Në faqen 7

NGJARJA

Pranga grekut në kufi, iu gjetën 800 fishekë në makinën që ngiste

Në faqen 10

LISTA

Tapi për 200 familje, ja përfituesit në të gjithë vendin

Në faqen 18-19

PRANGA 4 SHQIPTAREVE



Mbollën kanabis në mes të Athinës, policia e shokuar nga "shpikja"

Në faqen 9

Mjeku i përgjithshëm: Këshilla efektive për të mbrojtur shëndetin

## Qereshniku: Sa kancerogjene janë aparatet celulare

Ylli Merja: Si të humbisni peshë brenda një kohe të shkurtër

NGA VOLTIZA DURO

Në jetën tonë të përditshme, ne ndeshemi me valë të shumëllojshme, ndaj të cilave organizmi reagon në mënyra të ndryshme. Valët e detit zakonisht kanë një efekt relaksues mbi organizmi human, e kundërta ndodh



me valët elektromagnetike. Përveç valëve të dritës, në shtëpitë tona hyjnë edhe valë të prodhuara artificialisht si nga stacionet e radios, televizorët, telefonat celularë, kompjuterat dhe të tjera. Të gjitha këto valë transmetojnë energji, secila në ...

Suplement


# PROTESTA BILANCI

Uniformat blu kanë proceduar 61 persona për dhunën në protestë, mes tyre edhe Bardhi

## Protesta e opozitës, arrestohen 37 protestues, shumica 20-vjeçarë

Mes të ndaluarve, të rinj 17 dhe 18-vjeçarë

Policia e Tiranës ka proceduar penalisht 61 persona si përgjegjës për aktet e dhunës së ndodhur gjatë protestës së ditës së shtunë para Kryeministrit dhe Kuvendit. Uniformat blu kanë dhënë dje të dhënat zyrtare, ku ndër 61 personat e proceduar, kanë mundur të arrestojnë 37 prej tyre. Të gjithë ata akuzohen për veprime të dhunshme, prishje të qetësisë publike, kundërshtim dhe goditje të forcave të policisë, si dhe për shkatërrim prone. Njëpër një njoftimi të shpërndarë për mediat, policia ka bërë të ditur se mes personave që po ndiqen penalisht është edhe sekretari i përgjithshëm i PD-së, Gazment Bardhi, i cili është edhe personi përgjegjës për organizimin e protestës. "Policia e Tiranës nën drejtimin e Prokurorisë së rrethit Gjyqësor Tiranë ka arrestuar 37 shtetas për veprime të dhunshme mbi institucionet kushtetuese, mbi policinë dhe për shkatërrimin e pronës shtetërore e private gjatë zhvillimit të protestës së opozitës nga Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim ditën e djeshme para parlamentit", deklaroi policia. Sipas saj, veprimet procedurale janë kryer në bazë të një analize të pamjeve filmike, raportit të shërbimeve, si dhe provave të tjera të mbledhura nga grupi hetimor. Ndërkohë që policia bën të ditur se janë proceduar në gjendje të lirë dhe 23 persona të tjerë, përfshi edhe shtetasi G.B. (Gazmend Bardhi), si organizator i protestës të zhvilluar ditën e shtunë. Siç shihet edhe nga të dhënat e publikuara nga vetë policia, të gjithë protestuesit vijnë nga zona të ndryshme të vendit, nga veriu në jug, cka tregon për përhapjen e revoltës opozitare. "Për sulmet dhe veprimet e dhunshme janë arrestuar shtetasit: F. Ç., 37 vjeç, banues në Korçë; M. Ç., 35 vjeç, banues në Korçë; A. K., 20 vjeç, banues në Korçë; A. K., 20 vjeç, banues në Korçë; O. R., 28 vjeç, banues në Burrel; R. B., 23 vjeç, banues në Korçë; E. D., 24 vjeç, banues në Elbasan; A. R., 18 vjeç, banues në Tiranë; A. G., 26 vjeç, banues në Tropojë; H. T., 17 vjeç, banues në Tiranë; E. A., 18 vjeç, banues në Cërrik; L. Z., 29 vjeç, banues në Skrapar; R. B., 31 vjeç, banues në Tiranë", - thuhet më tej në këtë njoftim. Gjatë protestës së ditës së shtunë mbetën të lënduar nga veprimet e dhunshme 5 punonjës policie, të cilët ndodhen jashtë rrezikut për jetën, si dhe disa protestues, si dhe përfaqësues të medias. Policia bën të ditur se po punohet për identifikimin, kapjen dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të personave të tjerë që kanë kryer veprime të dhunshme gjatë protestës së djeshme. Materialet procedurale do t'i referohen Prokurorisë së rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprime të mëtejshme.



### POLICIA

Policia e Tiranës nën drejtimin e Prokurorisë së rrethit Gjyqësor Tiranë ka arrestuar 37 shtetas për veprime të dhunshme mbi institucionet kushtetuese, mbi policinë dhe për shkatërrimin e pronës shtetërore e private gjatë zhvillimit të protestës së opozitës nga Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim ditën e djeshme para parlamentit", - deklaroi policia.

### PERSONAT E ARRESTUAR NGA POLICIA

F. Ç.,	37 vjeç,	banues në Korçë.
M. Ç.,	35 vjeç,	banues në Korçë.
A. K.,	20 vjeç,	banues në Korçë
O. R.,	28 vjeç,	banues në Burrel.
N. B.,	23 vjeç,	banues në Korçë.
A. B.,	32 vjeç,	banues në Korçë.
E. D.,	24 vjeç,	banues në Elbasan.
D. M.,	24 vjeç,	banues në Elbasan.
I. D.,	26 vjeç,	banues në Shkozë.
A. Xh.,	31 vjeç,	banues në Burrel.
F. Gj.,	34 vjeç,	banues në Shkozë.
G. A.,	29 vjeç,	banues në Tiranë.
A. G.,	51 vjeç,	banues në Librazhd.
F. B.,	48 vjeç,	banues në Librazhd.
Sh. K.,	23 vjeç,	banues në Bathore Kamëz.
A. Zh.,	22 vjeç,	banues në Tiranë.
B. D.,	37 vjeç,	banues në Tiranë.
R. D.,	19 vjeç,	banues në Tiranë.
A. R.,	18 vjeç,	banues Tiranë.
D. R.,	37 vjeç,	banues në Shkodër.
T. K.,	20 vjeç,	banues në Kavajë.
H. R.,	22 vjeç,	banues në Kavajë.
O. S.,	18 vjeç,	banues në Kavajë.
M. P.,	20 vjeç,	banues në Tiranë.
D. M.,	19 vjeç,	banues në Tiranë.
A. S.,	24 vjeç,	banues në Tiranë.
A. G.,	26 vjeç,	banues në Tropojë.
E. N.,	23 vjeç,	banues në Lushnjë.
D. Gj.,	25 vjeç,	banues në Lushnjë.
K. S.,	21 vjeç,	banues në Berat.
M. B.,	20 vjeç,	banues në Berat.
E. B.,	27 vjeç,	banues në Tiranë.
A. P.,	61 vjeç,	banues në Tiranë.
H. T.,	17 vjeç,	banues në Tiranë.
E. A.,	18 vjeç,	banues në Cërrik.
L. Z.,	29 vjeç,	banues në Skrapar.
R. B.,	31 vjeç,	banues në Tiranë.

Korçë; A. B., 32 vjeç, banues në Korçë; E. D., 24 vjeç, banues në Elbasan; D. M., 24 vjeç, banues në Elbasan; I. D., 26 vjeç, banues në Elbasan; A. R., 18 vjeç, banues në Tiranë; A. G., 26 vjeç, banues në Tropojë; H. T., 17 vjeç, banues në Tiranë; E. A., 18 vjeç, banues në Cërrik; L. Z., 29 vjeç, banues në Skrapar; R. B., 31 vjeç, banues në Kor-

shkozë, Tiranë; G. A., 29 vjeç, banues në Tiranë; A. G., 51 vjeç, banues në Librazhd; F. B., 48 vjeç, në banues në Librazhd; Sh. K., 23 vjeç, banues në Bathore Kamëz; A. Zh., 22 vjeç, banues në Tiranë; B. D.,

37 vjeç, banues në Tiranë; R. D., 19 vjeç, banues në Tiranë; A. R., 18 vjeç, banues Tiranë; D. R., 37 vjeç, banues në Shkodër", - thotë Policia e Rendit në deklaratën e vet. Më tej lista vazhdon me të tjerë protestues të moshës nga 17 deri në 31 vjeç. "T. K., 20 vjeç banues në Kavajë; H. R., 22 vjeç banues në Kavajë; O. S., 18 vjeç, banues në Domje, Tiranë; M. P., 20 vjeç, banues në Kavajë; D. M., 19 vjeç, banues në Tiranë; A. S., 24 vjeç, banues në Tiranë; A. S., 24 vjeç, banues në Tiranë; A. G., 26 vjeç, banues në Tropojë; H. T., 17 vjeç, banues në Tiranë; E. A., 18 vjeç, banues në Cërrik; L. Z., 29 vjeç, banues në Skrapar; R. B., 31 vjeç, banues në Tiranë", - thuhet më tej në këtë njoftim. Gjatë protestës së ditës së shtunë mbetën të lënduar nga veprimet e dhunshme 5 punonjës policie, të cilët ndodhen jashtë rrezikut për jetën, si dhe disa protestues, si dhe përfaqësues të medias. Policia bën të ditur se po punohet për identifikimin, kapjen dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të personave të tjerë që kanë kryer veprime të dhunshme gjatë protestës së djeshme. Materialet procedurale do t'i referohen Prokurorisë së rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprime të mëtejshme.



### SHKURT

## Urinoi te Kryeministria, bashkia gjobit PD-në me 20 mijë lekë

Policia Bashkiake ka gjobitur Partinë Demokratike pasi një prej protestuesve ka urinuar në dyert e Kryeministrit. Lajmin e bëri publik dje vetë kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, me anë të një postimi në "Twitter", ku thotë se kjo është e pesta herë që PD-ja gjobitet për organizime të urinitimit publik dhe se paratë do mbahen direkt nga llogaria. E me sa duket, veprimi i këtij protestuesi i ka "djegur" më shumë se e gjithë ndotja që prodhoi protesta e djeshme, pasi edhe gjoba është e "majme", në vlerën e 20 mijë lekëve. "PD-ja gjobitet për të 5-ën herë për organizime të urinitimit publik! Si dhe më parë, paratë do t'i merren direkt nga llogaria! Imagjino ç'alternativë qeverisëse është një parti që i shpëton në brekë! Hipokrizia e 'Mbrotërrin' duket qartë te ndërtesa e Gherardo Bosios", - shkroi Veliaj. Godina e Kryeministrit u projektua më 1939-ën nga arkitekti italian Gherardo Bosio dhe në fillim mbajti emrin "Pallati i Mëkëmbësisë". Ajo është pjesë e aksit monumental të Tiranës. Gjatë protestës së opozitës ditën e shtunë, disa protestues qëlluan me bojë në muret e godinës së Kryeministrit, ndërsa një prej tyre në mënyrë simbolike urinoi në to. Fotoja dhe videoja bëri xhiro në rrjetet sociale, ndërsa simbolika e saj kishte të bënte me atë të protestës, pra një popull që nuk do më qeverinë e vet.

## Rama: Ata prish e ne ndreq, ata ndot e ne pastro, ata klith e ne fito

Një ditë pas protestës së të shtunës, ndërmarrjet e Bashkisë së Tiranës kanë pasur jo pak punë për të rikuperuar dëmet dhe atë që la pas tubimi i opozitës. Natyrisht që puna më e vështirë ishte pastrimi i bojës dhe mbetjeve të tjera që protestuesit hodhën në faqet dhe dritaret e godinës së Kryeministrit. Një foto të këtij angazhimi e përcolli edhe vetë kryeministri Edi Rama për ndjekësit e tij në "Instagram", ku nuk nguroi të japë dhe një mesazh thumbues për opozitën. "Ata prish e ne ndreq, ata ndot e ne pastro, ata klith e ne fito", - shkruan kryeministri. Krahas punës të godina e Kryeministrit, punonjësit bashkiake punuan edhe para selisë së seancave plenare të Kuvendit të Shqipërisë, ku ndër të tjera riparuan edhe trotuarin me gurë që ishin shkullur gjatë protestës.



## SHKURT

### Spiropali: Kush tenton t'i vërë flakën këtij vendi, do të digjet vetë

Thuajse e gjithë mazhoranca është përfshirë dhe në një fushatë për të denoncuar aktet e dhunës që shoqëruan protestën e opozitës të ditës së shtunë para Kryeministrisë dhe para Kuvendit. Kështu, pas mesazheve të kryeministrit Edi Rama, ministrit të Brendshëm, Sandër Lleshaj dhe ministres së Drejtësisë Etilda Gjonaj, dhe lidhur me këto ngjarje ka reaguar edhe ministria për Marrëdhëniet me Parlamentin, Elisa Spiropali. Njëpërmjet një videomesazhi të shpërndarë në rrjetet sociale, Spiropali tha se kush tenton t'i vërë flakën këtij vendi, do të digjet edhe vetë. "Pa asnjë tjetër përveç shkatërrimit dhe asnjë qëllim tjetër përveç shantazhimit të shumicës me ura zjarri në gjuhë dhe në duar, këta udhëheqës të diskredituar, me një çetë punonjësisht të bashkive të djathta e me një grusht të rinjsh të qorruar nga propaganda e tyre e sherrit dhe e dhunës, lanë kokrrën e namit në atë që e trumbetuan si ditën e ikjes së Edi Ramës e të qeverisë! Mësynë bulevardin, Kryeministrinë dhe parlamentin e Shqipërisë, si një trup pa kokë dhe pa sy lëshuan piskamat e ngjirura nga fyti i liderit, që lider kurrë nuk bëhet dhe e mbyllën me turp, duke dhunuar policinë dhe duke i vënë zjarrin pronës publike dhe private. Për disa orë rresht forcat e policisë u sulmuan me kapsolla, zjarr e benzinë dhe u plagosën pabesisht nga këta të çoroditur që vejevinin tek Ura e Tabakëve në kërkim të sherrit, konfliktit, rrëmujës e hatasë, që kanë në kokat e tyre boshe", - tha Spiropali.

### Manastirliu: Të plagosurit e protestës lanë spitalin pas mjekimit

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Oger Lta Manastirliu, bëri të ditur se 11 personat e lënduar gjatë protestës së opozitës tashmë kanë dalë nga spitali dhe janë në gjendje të mirë shëndetësore. Ajo thotë se ekipet mjekësore ishin në gatishmëri për të trajtuar qytetarët dhe policët e lënduar nga protesta e dhunshme e opozitës. "11 personat e lënduar gjatë protestës së dhunshme të opozitës kanë lënë spitalin në gjendje të stabilizuar. Gatishmëria e ekipeve tona mjekësore gjatë dhe pas protestës së opozitës, që precipitoi në mënyrën më të shëndetshme dhe të papërgjegjshme në dhunë ndaj forcave të rendit, ishte si çdo herë maksimale, duke trajtuar në kohë policët dhe qytetarët e lënduar. Dëshpërimi i atyre, që të vetmen gjuhë që njohin kanë gjuhën e shashkave dhe të vetmen alternativë, dhunën ndaj institucioneve, shkaktoi lëndime fizike mbi pesë policë, të cilët u goditën në fytyrë dhe gjymtyrë. Fatmirësisht, pa pasja të rëndësishme të shëndetit e tyre", tha Manastirliu.

Ministri i Brendshëm foli për skenarë të opozitës, për të sulmuar institucionet

# Rama: Policia tregoi dinjitet, dhunuesit po braktisen nga qytetarët

"Pati më tepër dhunë, ky është një lajm i keq"

Mazhoranca dhe opozita janë për plasur dhe në distancë mbi dhunën dhe pasojat e protestës së ditës së shtunë. Ndërsa opozita ka akuzuar qeverinë dhe policinë se ka ushtruar dhunë ndaj protestuesve, shumica qeverisëse nga ana tjetër ka akuzuar drejtësit e kampit të djathtë se në mungesë të shprehës për të fituar me zgjedhje, dhunuan institucionet dhe policinë. Njëpërmjet një postimi në rrjetet sociale, kreu i qeverisë i doli në mbrojtje Policisë së Shtetit, e cila sipas tij tregoi dinjitet nëpërmjet sjelljes së saj gjatë protestës. "Policia e Shtetit dha një tjetër shembull kuptimplotë dinjiteti në krye të detyrës, ndërsa dhunuesit e saj një tjetër arsye për t'u braktisur nga çdo qytetar i denjë i kësaj republike - komunikim publik i ministrit të Brendshëm, Sandër Lleshaj", - shkroi Rama në rrjetin social "Facebook".

**LLESHAJ**  
Ndërkohë që ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj, në një dalje të posaçme për mediat, dhe foli për skenarë të mirorganizuar për sulmin e policisë dhe institucioneve legjitime të vendit. Lleshaj numëroi sipas tij, shkeljet e bëra gjatë protestës së djeshme, madje duke akuzuar përfaqësuesit e opozitës edhe për thirrje antikushetuese. "Pati më tepër dhunë, ky është një lajm i keq, që tregon dëshpërimin e organizatorëve. Protesta e mbremshme u zhvendos në mënyrë të pabesë, tinëzare nga vendi ku ishte kërkuar, të Kryeministria, drejt parlamentit duke krijuar pasojë të rënda, duke përfshirë qytetarët të palidhur me protestën e duke sjellë dëme. Nga ana e organizatorëve nuk ishin marrë asnjë masë për sigurinë e saj, nuk ishte shpenzuar asnjë burim njerëzor apo material që protesta të zhvillohej brenda hullisë ligjore. Përkundrazi, nga organizatorët ishin marrë masa për të hartuar plan sulmi dhe për të përdorur dhunë kundër institucioneve kushtetuese. Gjatë protestës u konsumuan thirrje të hapura antikushetuese, për dhunë, për revolucion", deklaroi ministri i Brendshëm. Lleshaj tha se u përdor një arsenal lëndësh shpërthyes



Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj

## KRIMI

"Protesta kontribuoi edhe njëherë për ta zhvendosur vëmendjen e policisë nga krimi te protesta. Policia dha shembull dinjiteti, dhunuesit një tjetër arsye për t'u braktisur nga çdo qytetar. Policia reagoi me profesionalizëm ndaj njerëzve që kanë vrarë", - u shpreh ministri Lleshaj.

## Gjonaj: Të hetohen përgjegjësit e dhunës, opozita ka frikë drejtësinë

Ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, u bëri thirrje dhe organeve të drejtësisë të hetojnë dhe çojnë para bankës së të akuzuarve përgjegjësit e dhunës gjatë protestës së të shtunës. Njëpërmjet një deklarate për mediat, Gjonaj theksoi se sjellja e opozitës është pasojë e frikës që ajo ka nga drejtësia e re që po vendoset në vend. "Të gjithë ata që në formë të ndryshme nxitën dhe kryen akte të dhunshme duhet të marrin dënime sipas ligjit. Është e papranueshme dhuna në çfarëdo lloj proteste, por është e patolerueshme kur organizohet nga partitë politike. Shqiptarët panë dhe kuptuan se protesta e djeshme si ato të muajve të fundit nuk janë të qyteta-



rëve, por protesta të nxitura me dhunë për interesat e liderit të opozitës", - tha Gjonaj. Ministria e Drejtësisë evidentoi faktin që opozita kërkon të destabilizojë vendin tani që Shqipëria pret një përgjigje pozitive sa i përket procesit të hapjes së negociatave për anëtarësim në BE. "Qëllimi i tyre është i ditur, kërkohet destabilizimi i ven-

dit, sidomos në këtë periudhë. Nga këto akte dëmtohet Shqipëria, ndaj nxisim organet që të hetojnë në mënyrë të pavarur e të dërgojnë përpara drejtësisë këta persona. Këto shfaqje të dhunës e dëmtojnë Shqipërinë edhe në sytë e shteteve të tjera, por ne do të çojmë përpara reformat e drejtësisë", - tha Gjonaj.

të ndaluara e të rrezikshme nga të cilat u shkaktuan dëme të mëdha. "Protesta kontribuoi edhe njëherë për ta zhvendosur vëmendjen e policisë nga krimi te protesta. Policia dha shembull dinjiteti, dhunuesit një tjetër arsye për t'u braktisur nga çdo qytetar. Policia reagoi me profesionalizëm ndaj njerëzve që kanë vrarë", - u shpreh ministri Lleshaj.

## PJESËMARRJA

Një ndryshim tjetër nga protestat e mëparshme të

opozitës ishte edhe pjesëmarrja e ulët në tubim, që për Lleshajin ishte një lajm i mirë. "Pati shumë më pa pjesëmarrës, gjë që përbën një lajm pozitiv se tregon që shqiptarët po e kuptojnë se pas kujt nuk duhet të rendin dhe pas kujt duhet të shkojnë", - tha Lleshaj. Sipas tij, përkallëzimi i protestës po e bën atë një problem të rendit publik, ndërsa paralajmëroi se organizatorët dhe ata që bëjnë deklaratat dhe nxisin akte dhunë kundër organeve

kushtetuese do të mbajnë përgjegjësi. "Përkallëzimi i protestës po e zhvendos nga një problem i rendit publik, në një problem të rendit kushtetues. Organizatorët dhe pjesëmarrësit mund të përballen me akuzë që kanë të bëjnë me cenimin dhe sulmet e organeve kushtetues të vendit. Kjo protestë nuk po godet qeverinë, madje e forcon atë. Po godet shtetin shqiptar, imazhin e tij dhe perspektivën euroatlantike", - u shpreh Lleshaj.

## AKSIONI OPOZITAR REAGIME

PD akuzoi ministrin e Brendshëm se ka përdorur dhunë ndaj protestuesve

# Basha: Jemi krah njerëzve, nuk ka kompromis me ëndrrën tonë

*Bardhi: Edi Rama është një kufomë politike*

Opozita ka dënuar dje në një zë sjielljen e policisë gjatë protestës së të shtunës, përdorimin e gazit dhe më pas arrestimin e protestuesve. Njëpërmyjet një sërë reagimesh zyrtare edhe në rrjetet sociale, drejtuesit më të lartë të opozitës kanë theksuar vendosmërinë e tyre për ta çuar deri në fund betejën për zgjedhje të lira dhe të ndershme pa Ramën kryeministër. Kryetari i PD-së, Lulzim Basha, njëpërmyjet dy reagimeve të njëpasnjëshme në rrjetet sociale ka theksuar se opozita do t'u qëndrojë në krah protestuesve dhe qytetarëve që janë ngritur kundër kësaj qeverisjeje. "Ne jemi deri në fund në krah të njerëzve që janë ngritur kundër qeverisë-bandë, që bashkë me krimin dhe oligarkët ka vjedhur dhe dhunuar shqiptarët, ka shkatërruar demokracinë dhe shtetin ligjor dhe po kërcënon të ardhmen europiane të Shqipërisë! Fati i qeverisë-bandë është rrëzimi i saj! Krerët e kësaj bande i pret burgu, që sot e kanë mbushur me protestues të pafajshëm!", - shkroi Basha. Më tej, ai bëri të qartë se opozita nuk tërhiqet nga beteja e saj dhe se kompromisi me ëndrrën e shqiptarëve nuk do të ketë. "Ky është fundi i qeverisë-bandë të kapur duke vjedhur zgjedhjet me kriminelët, kërcënimin nr.1 për demokracinë, sigurinë, mirëqenien, Nuk ka kompromis me ëndrrën tonë 'E duam Shqipërinë si gjithë Europa', me standardet europiane për zgjedhje të lira, drejtësi dhe ekonomi të lirë!", - shkroi Basha në një tjetër reagim.

### BARDHI

Ndërkohë që sekretari i përgjithshëm i Partisë Demokratike, Gazmend Bardhi, duke folur nga foltorja e selisë blu tha se kryeministri Edi Rama e ka blerë pushtetin me paratë e kriminit dhe se s'ka moral të burgosë popullin e tij. Ndaj, ai tha se askush nuk mund ta ndalë popullin, duke iu referuar pikërisht ndalimeve të shumta që bëri policia pas protestës së fundit. "Në Shqipëri ka vetëm një grupim antikushitetues dhe me pushtet të paligjshëm politik. Ky grupim është banda e Edi Ramës, i cili e ka blerë pushtetin me paratë e pista të kriminit të organizuar. Dalja nga vritat e miut ku ishin fshehur



Protesta e 13 prillit

### MESAZHI

"Ky është fundi i qeverisë-bandë të kapur duke vjedhur zgjedhjet me kriminelët, kërcënimin nr.1 për demokracinë, sigurinë, mirëqenien. Nuk ka kompromis me ëndrrën tonë 'E duam Shqipërinë si gjithë Europa', me standardet europiane për zgjedhje të lira, drejtësi dhe ekonomi të lirë!", - shkroi Basha në një tjetër reagim.

## Dhuna ndaj protestuesve: Shtet horrash, djegia e makinës e organizuar

Në një dalje të posaçme për mediat, ish-kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, ka sulmuar ashpër ministrin e Brendshëm, Sandër Lleshaj dhe kryeministrin Edi Rama si autorët e dhunës së ushtruar ndaj protestuesve dhe arrestimeve të shumta në komisariate. Vasili i ka drejtuar disa pyetje ministrit të Brendshëm, të cilin e quajti "ministër kriminel". Ai pyeti se ku i gjeti provat e filmimit policia kur dritat të parlamenti i fiku vetë? Vasili tha se ky është shtet i horrave dhe se hajdutët e qeverisë që njihen deri në Uashington nuk arrestohen, por arrestohen qytetarë që mbrojnë banesat e tyre. "Mediat botërore e konsideruan mitingun më të madh të

parë ndonjëherë në Ballkan. Dhe kjo ishte prova e një vullneti qytetar të jashtëzakonshëm të dimensioneve të papërmbajtshme. Por, po dje shteti i horrave dhe nuk druhen ta them me gojën plot këtë gjë, konsumoi një skenar të fëlliqur, të programuar mirë, të provokimeve të njëpasnjëshme, të cilave opozita nuk iu përgjigj, nuk ra pre e tyre, por bëri që organizatorët e këtyre kurtheve dhe këtyre provokimeve të bien vetë brenda", - tha Vasili. Ai theksoi se djegia e makinës para Kuvendit u bë në mënyrë të qëllimshme nga policia, pasi fiku dritat në territorin përreth. "Jo më larg se dje u konsumua një akt i vërtetë terrorist me djegien e një makine anonime, të paldentifikuar, të vendosur në mes të protes-

tuesve, shpërthimi i së cilës mund të kishte marrë jetën e dhjetëra protestuesve. Jam sot këtu t'i kërkoj këtij ministri të pacipë që del e bën komente për protestuesit, cili ishte pronari i makinës? Cili ishte ai që e futi atë makinë atje? Ndërkohë që i gjithë përimetri i sigurisë ishte i garantuar nga forcat e rendit dhe ku përveç mjeteve të urgjencës mjekësore dhe mjeteve të medias, nuk mund të hynte askurrkush tjetër?! Kush ishte pronari i makinës, po e përsëris edhe njëherë? Kush i fiku dritat në të gjitha ambientet e mitingut, ku në vend të sigurisë për zhvillimin e një mitingu paqësor, ashtu siç çreshin në mënyrë historike", deklaroi Vasili.

duke i trajtuar si qytetarë të dorës së dytë", - tha Bardhi. Më tej, ai theksoi se s'ka asnjë forcë që ta ndalë më tanzi zemërimin e popullit të shprehur nëpër protesta. "Edi Rama është një kufomë politike. Ai nuk ka as forcë, as moral të akuzojë apo të burgosë popullin e bashkuar kundër qeverisë së tij kriminale dhe ilegjitime! Beteja jonë është për Shqipërinë si gjithë Europa! Askush nuk mund të na ndalë më!", - deklaroi Bardhi nga selia e PD-së.

### SHKURT

#### Numri 2 i PD: Llesh kimiku sajoj skenarë me djegie makinash false

Partia Demokratike është e bindur se makina e djegur dhe policët e plagosur janë skenarë i ministrit të Brendshëm, Sandër Lleshaj. Sekretari i Përgjithshëm i PD-së, Gazmend Bardhi, shkroi dje në "Twitter" se pas grabitjes në Rinas, ky skenar është suksesi i dytë në tri ditë i Lleshajt. "Janë të tmerruar nga bashkimi i shqiptarëve! S'u mjaftoi gazi helmues dhe uji me presion i përdorur në mënyrë kriminale kundër qytetarëve. Turp! Llesh kimiku sajoj skenarë me djegie makinash false e policët të dhunuar për të mbuluar frikën e shefit të tij të vetmuar. Pas grabitjes në Rinas, djegia e makinës false dhe policët të dhunuar është 'suksesi' i dytë i Llesh kimikut në 3 ditë. Parlament me vota false, qeveri false, kryeministër false! Shteti i Ramës ka marrë fund! Ne jemi shumica morale dhe politike! Nuk ka kthim pas!", - shkroi Bardhi.

#### Avokati i Popullit: Kundërshtimi protestuesve ka qenë i menaxhueshëm

Jo vetëm opozita, por edhe Avokati i Popullit shpreh shqetësimin për aktet e dhunës ndaj protestuesve dhe në mënyrë të veçantë përdorimin e gazit në përmasa të mëdha mbi qytetarët. Në një reagim të shpërndarë për mediat, ky institucion thekson se reagimi i qytetarëve ndaj policisë ka qenë i menaxhueshëm, ndërsa nënvizon se përdorimi i gazit nga policia nuk bazohet në një protokoll, ku të gjithë të dinë përmbajtjen e lëndës së hedhur. "Protesta është zhvilluar përgjithësisht në mënyrë paqësore dhe se episodet e dhunës apo të kundërshtimit të forcave të policisë nga ana e protestuesve kanë qenë në një shkallë të menaxhueshme. Por, pavarësisht sa më sipër Avokati i Popullit nuk pajtohet me veprimet e dhunshme të çfarëdo shkalje apo natyre të drejtuara ndaj individit, institucioneve shtetërore apo pronës private", - thekson AP-ja. Më tej ky institucion bën të ditur se ekipet monitoruese të Avokatit të Popullit kanë qenë në terren prej orës 18:00 deri në përfundim të protestës për të parë dhe dokumentuar nga afër çdo zhvillim. "Avokati i Popullit ka konstatuar se protesta është zhvilluar përgjithësisht në mënyrë paqësore dhe se episodet e dhunës apo të kundërshtimit të forcave të policisë nga ana e protestuesve kanë qenë në një shkallë të menaxhueshme. Por, pavarësisht sa më sipër Avokati i Popullit nuk pajtohet me veprimet e dhunshme të çfarëdo shkalje apo natyre të drejtuara ndaj individit, institucioneve shtetërore apo pronës private", - thuhet në këtë deklaratë.



**Protesta e opozitës ka pasur jehonë të madhe ndërkombëtare**

**Gazeta italiane: Sondazhet favorizojnë opozitën përballë PS-së**

Protesta e opozitës, e mbajtur ditën e shtunë ka marrë vëmendjen e pothuajse të gjitha mediave ndërkombëtare prestigjioze. Nuk ka munguar pasqyrimi i saj edhe në mediat e vendit fqinj, Italisë, të cilat në vijimësi kanë shfaqur një interes të lartë lidhur me zhvillimet politike në vendin tonë. Gazetari italian, Giancarlo Padovan i ka kushtuar një shkrim në gazetën "Il Fatto Quotidiano", protestës së opozitës së bashkuar, ku shkruan se mobilizimi i madh anti-Rama për zgjedhje të parakohshme nuk flet vetëm për një mbështetje për Partinë Demokratike, por është edhe tregues i situatës ekonomike jo të mirë. Po kështu, ai ka folur edhe për



Artikull i shkruar në median italiane

sondazhet, që siç shkruan, nxjerrin fitues PD-në dhe aleatët e saj. "Mobilizimi i madh anti-Rama nuk flet vetëm për një mbështetje për Partinë Demokratike, por është edhe tregues i sit-

uatës ekonomike jo të mirë. Të rinjtë shqiptarë po emigrojnë drejt Gjermanisë me viza pune. Çdo ditë para ambasadës gjermane janë në radhë me qindra njerëz. Më të pafatët tentojnë edhe

rrugë të tjera, si ato të azilit apo edhe të klandestinitetit, çka është më e rrezikshme për jetën. Ka syresh që për të mbërritur në Britani të fshehur në një kamion janë të gatshëm të paguajnë edhe 10 mijë euro", - shkruhet në këtë artikull. Gazetari italian u referohet edhe sondazheve, të cilat sipas tij tregojnë një mbështetje gjithnjë e më të madhe për opozitën. "Sipas një sondazhi të IPR, një institut italian sondazhesh, Partia Demokratike dhe LSI (Lëvizja Socialiste për Integrim) marrin 53% të votave, përkundërt 44% të Partisë Socialiste të Edi Ramës", - thuhet më tej në këtë artikull.

Numri i dy i PD-së është shprehur i sigurt se nuk do ketë votime në 30 qershor me Ramën

**SHKURT**

**Salianji: Lleshaj të shtunën helmoi popullin me gaz, dje e shkriu gazet**

Ndaj sjelljes së policisë në protestën e së shtunës ka reaguar ashpër edhe ish-deputeti demokrat, Ervin Salianji, i cili e ka cilësuar komike deklaratën e ministrit të Brendshëm, Sandër Lleshaj, i cili thekson se uniformat blu ishin sulmuar. Njëpërmjet një statusi në rrjetet sociale, Salianji jo pa ironi deklaroi se Lleshaj të shtunën e helmoi popullin me gaz, por dje me deklaratën e tij i shkriu shqiptarët gaz. "Lleshaj na mbyti me gaz. Dje nga frika helmoi popullin me gaz helmues, sot me servilizmin deri në budallallëk shkriu shqiptarët gazit", - shkroi Salianji. Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj, dje para mediave ku tha se protesta e djeshme pati më tepër dhunë, çka tregon sipas tij dëshpërimin e organizatorëve, të cilët i akuzoi edhe për një plan sulmi ndaj institucioneve. Lleshaj numëroi sipas tij, shkeljet e bëra gjatë protestës së djeshme, madje duke akuzuar përfaqësuesit e opozitës edhe për thirrje antikushtetuese.

**Braimllari: Rama po përdor një "gjeneral të vdekur" kundër popullit**

Pas shoqërimit dhe arrestimeve të disa protestuesve nga Policia e Shtetit, reagoi dje edhe ish-deputeti i LSI-së, Endrit Braimllari. Njëpërmjet një komenti në rrjetin social "Facebook", Braimllari shprehet se qytetarët po dhunohen, pasi protestuan për të drejtat e tyre, ndërsa pohon se shteti grabitësit e Rinasit i lë të lirë. "Edi Rama dhe Sandër Lleshaj dhunojnë dhe arrestojnë qytetarë të pafajshëm, që protestojnë në të drejtën e tyre dhe lënë të lirë grabitësit shtetërorë në Rinas. Përdorimi i gazit helmues në sasi të madhe në një protestë qytetare është gjenocid", - shkroi Braimllari. Më tej, ai thekson se ministri i Brendshëm reagon për protestuesit, por prej kohësh nuk ka asnjë koment për situatën e rendit në vend. "Sandër Lleshaj gjen kohë të reagojë për protestat qytetare, por nuk ka asnjë fjalë për mungesën e sigurisë në vend, për numrin e lartë të vrasjeve, për grabitjen e Rinasit, për vjedhjen e hapur të Unaza e Ri, për dhunën që ushtron mbi banorët e 'Bulevardit të Ri' duke dhunuar gra, fëmijë e të moshuar. Kjo është fytyra e vërtetë e një qeverie të degraduar, ku po përdoret një 'gjeneral i vdekur' kundër një populli", shkroi Braimllari.

**Basti i Palokës: Ska zgjedhje pa PD-në. Nëse ndodh, iki nga politika**

*"Unë do të dal nga politika dhe këtë po e them këtu"*

Opozita është e bindur se në 30 qershor nuk do të ketë zgjedhje pa pjesëmarrjen e Partisë Demokratike, Lëvizjes Socialiste për Integrim dhe partive të tjera aleate të tyre. Aq e fortë është kjo bindje sa nënkryetari i Partisë Demokratike u premtim mbështetësve të tij se në rast se kjo ndodh, atëherë ai është gati të vërë bast dhe të largohet nga politika përgjithmonë. Deklaratën ai e bëri i gjatë intervistës në rubrikën "Opinion" në "News 24", ku dhe foli lidhur me protestën dhe aksionin opozitar: "PD-ja është rritur në sondazhe në pak kohë me 10 pikë. Ne po ecim si opozitë dhe rruga jonë është pa kthim. Vendimi politik nuk ka më ekstrem. Do të ecim me këtë formë, me revolta dhe me çdo mjet deri sa ta detyrojmë Ramën të realizojë zgjedhje të ndershme. Ne nuk do ta lejojmë këtë. Nëse Rama zhvillon dot zgjedhje pa opozitën, unë do të dal nga politika dhe këtë po e them këtu", - tha Paloka. Gjithashtu, Paloka foli edhe për protestën dhe makinën e djegur para Kuvendit, teksa e cilësoi si rast provokimi dhe përjashtoi faktin që opozita të jetë gisht në këtë skenar. "Kjo polici iu çon gaz lotsjellës qytetarëve në shtëpi, iu çan kokat dhe iu thyen këmbët. Nuk ka zot që ia lan faturat. Policët nuk janë plagosur? Ata flasin për dhunë, pse? Sepse janë hedhur fishekzjarrë. Nuk ka pasur dhunë. Gazetarët u dhunuan dhe u gjakosën, por edhe 15 qytetarë. Nuk ka ta të drejtë ta përdorë gazin në protesta të tilla. Këto nuk kemi ku t'i verifikojmë, sepse prokuroria, gjykata dhe policia janë të Ramës dhe të qeverisë. Gazi është hedhur kur Basha po fliste para mediave. Të gjithë do të mbajnë përgjegjësi. Të jenë të bindur se nesër një më një do të mbajnë përgjegjësi. Nesër asnjë nuk do të harrohet. Nesër do të japin llogari së bashku me shefin e tyre.



PD-ja ka mbajtur një qëndrim zyrtar dhe është shprehur se djezia e makinës ka qenë një provokim dhe makina, siç rezultoi, ka qenë me targa false, që rezultoi në një makinë tjetër e regjistruar në Sukth. Sipas Palokës, nëse do të vijohet kështu me revolta qytetare nga njëra anë dhe me arrogancë të qeverisë nga ana tjetër, pamje si të djeshmet mund të bëhen rutinë. "Kështu siç po shkon puna, këto pamje do të jenë normale në rrugët e Tiranës. Policia duhet të ruajë rendin dhe sigurinë dhe të kapë grabitësit. Si kënaqësi, si u zhdukën? Ata duhet të kapë policia, po ata nuk i kap dot, sepse i ka në parlament. Siguria shkelet çdo

ditë nga qeveria dhe jo nga qytetarët", - u shpreh Paloka. Më tej, ai këmbënguli edhe një herë duke theksuar se Rama dhe faktori i ndërkombëtar e dinë shumë mirë se nuk do ketë zgjedhje pa opozitën. "Nuk mund të ketë zgjedhje pa opozitën, Rama e di i pari dhe e dinë edhe diplomatët. Nuk ka datë dhe nuk mund ta them se kur mund të largojmë Ramën. Në këtë mënyrë siç po shkon, nga revolta qytetare në njërin anë dhe nga krahu tjetër arroganca e qeverisë, mund të shkojmë edhe të një përplasje që nuk e do askush", - u shpreh Paloka.

**ZGJEDHJET**  
"Nuk mund të ketë zgjedhje pa opozitën, Rama e di i pari dhe e dinë edhe diplomatët. Nuk ka datë dhe nuk mund ta them se kur mund të largojmë Ramën. Në këtë mënyrë siç po shkon, nga revolta qytetare në njërin anë dhe nga krahu tjetër arroganca e qeverisë, mund të shkojmë edhe të një përplasje që nuk e do askush", - u shpreh Paloka.

## KRIZA ZGJEDHJET

Politika duhet t'i japë zgjidhje krizës që të djathtët të regjistruhen në KQZ

# Opozita, një javë kohë për regjistrimin në zgjedhjet vendore

PS dhe 21 parti do të marrin pjesë në zgjedhje

Kjo javë duhet të jetë intensive për kampet politike sa i përket gjetjes së një zgjidhjeje për krizën që ka përfshirë vendin dhe për të bërë të mundur futjen e opozitës në zgjedhjet e ardhshme vendore të 30 qershorit. Kjo, pasi 21 prilli është afati i fundit brenda të cilit partitë politike kanë mundësi që të regjistruhen si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për pushtetin vendor. Kodi Zgjedhor përcakton se regjistrimi i partive politike në KQZ duhet të bëhet 70 ditë para datës së mbajtjes së zgjedhjeve, afat ky që përfundon me datën 21 prill. Pra, që partitë politike të opozitës të regjistruhen fillimisht si subjekte zgjedhore dhe më pas edhe si koalicion, pa qenë e nevojshme që të shkelet ligjit, duhet që krizës politike t'i jepet zgjidhje brenda kësaj jave dhe që ato të paraqesin kërkesat në KQZ.

### MAZHORANCA

Pavarësisht vendosmërisë së opozitës për të qenë e bashkuar në vendimin e saj për të mos u futur në një palë zgjedhje me Ramën kryeministër dhe me këtë qeveri, mazhoranca në krahun tjetër ka vijuar gjatë këtyre javëve të tregohet e palëkundur në qëndrimin e saj për të shkuar në zgjedhjet lokale edhe pa opozitën. Këtë mesazh është përpjekur ta tregojë jo vetëm nëpërmjet deklaratave të njëpasnjëshme të drejtuesve të shumicës qeverisë, por edhe nëpërmjet regjistrimit në KQZ thaujë të të gjitha partive që janë pjesë e koalicionit të majtë. Deri më tani Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka regjistruar plot 22 parti politike që kanë shprehur më parë dëshirën për të marrë pjesë në zgjedhjet vendore. Bëhet fjalë për PS-në dhe aleatët e saj, si dhe të ndonjë forcë tjetër të dorës së tretë, që më parë ka qenë në koalicion me PD-në dhe tashmë është regjistruar në KQZ. Kështu veç PS-së, në KQZ është regjistruar edhe PSD-ja e Skënder Gjinushit, Partia Socialiste e Moderuar e Gjergj Kojës, Partia Unitetit Kombëtar e Idajet Beqirit. Ndërkohë, mungojnë ende në listën e partive të regjistruara edhe Partia Demokracia Sociale e Paskal Milos, apo Partia Socialiste e Vërtetë '91 e Petro Koçit. Gjithsesi, burime nga PS-ja



## Aleatët i binden PS-së, regjistruhen për zgjedhjet lokale

Rreth 2 muaj më parë Partia Socialiste zhvilloi një tryezë koordinuese me të gjitha ato parti, që do të jenë pjesë e koalicionit të saj për zgjedhjet e ardhshme vendore. Produkt i asaj tryeze ishte edhe arritja e një deklaratë të përbashkët, ku ndër të tjera forcat firmëtare të saj binin dakord që të regjistroheshin në KQZ për zgjedhjet vendore, konform afateve ligjore. Dhe duket se të gjitha partitë politike pjesëmarrëse në këtë tryezë e kanë përbushur këtë zotim, pasi kur mbetet edhe një javë nga afati i fundit i regjistrimit të partive poli-

bëjnë me dije se edhe këto dy forca do të regjistruhen brenda këtij afati në KQZ për ta çuar kështu në 24 numrin e partive që kanë vendosur të marrin pjesë në zgjedhjet e 30 qershorit.

### OPOZITA

Ndërkohë që kampi tjetër politik, ai opozitar, deri më tani nuk ka pasur asnjë rrjedhje sa i përket regjistrimit në KQZ. Thaujë të gjitha partitë kryesore të këtij koalicioni nuk kanë paraqitur deri më tani asnjë interes ligjor për t'u bërë pjesë e zgjedhjeve vendore,

tike në zgjedhjet e ardhshme, në KQZ rezultun se janë regjistruar vetëm 22 parti. Por, ajo që bie në sy është se nga 22 parti të regjistruara, vetëm dy prej tyre janë parti parlamentare dhe bëhet fjalë për PS-në dhe PSD-në e Skënder Gjinushit. Ndërkohë, pritet që në ditët në vijim të regjistruhen nga KQZ-ja edhe disa parti të tjera aleate të PS-së, siç është PDS e Paskal Milos, PSV91 e Petro Koçit apo edhe G99 e Ervin Metës. Gjithsesi, duhet thënë se të gjitha partitë aleate të PS-së janë parti të dorës së dytë dhe të tretë dhe të gjitha së bashku në zgjedhjet e fundit për pushtetin vendor morën

184 mijë vota. Partia më e madhe aleate e Partisë Socialiste në koalicionin e ri rezultun të jetë Partia Social Demokrate e Skënder Gjinushit. PSD në zgjedhjet e shkuara ndonëse konkurroi jashtë koalicioneve, arriti të sigurojë 22 mijë vota. Pas saj vjen Partia Demokracia Sociale e Paskal Milos, e cila brenda koalicionit me PS-në mundi të marrë 20 mijë vota në rang kombëtar. Partia e tretë më e madhe aleate e PS-së është PSV e Petro Koçit, e cila në 2015-ën ka marrë 17500 vota. Pas saj vjen Partia Socialiste e Moderuar e Gjergj Kojës, e cila ka marrë 15 mijë vota.

### AFATET

Eksperienca e mëparshme ka treguar se afatet nuk janë shumë problem për politikëtonë, pasi në rast të një marrëveshjeje mes palëve, ky regjistrim mund të bëhet edhe më vonë. Rasti më i fundit i thyerjes së këtyre afateve ishte 2017-ta, ku në një krizë të ngjashme të gjitha partitë e opozitës u regjistruan në tejkalim të afateve ligjore.



### SHKURT

## Neni 64/ Regjistrimi i partive politike në zgjedhje

1. Çdo parti politike duhet të paraqesë kërkesën për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ jo më vonë se 70 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

## Neni 65/

## Regjistrimi i koalicioneve zgjedhore

1. Dy ose më shumë parti politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në KQZ, sipas nenit 64 të këtij Kodi, mund të regjistruhen në KQZ si koalicion zgjedhor në shkallë vendi jo më vonë se 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

2. Partia politike pjesëmarrëse në një koalicion nuk mund të marrë pjesë në një koalicion tjetër dhe as të paraqesë kandidatë apo listë shumëmore kandidatësh jashtë koalicionit ku ajo bën pjesë.

## LISTA E PARTIVE QË JANË REGJISTRUAR PËR ZGJEDHJET E 30 QERSHORIT

1. Partia Socialiste e Shqipërisë
2. Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet
3. Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar
4. Partia Ora e Shqipërisë
5. Partia për Liri, Demokraci dhe Etikë
6. Partia Socialdemokrate e Shqipërisë
7. Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen
8. Partia Ardhmëria Shqiptare
9. Partia Demokracia e Re Europiane
10. Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane
11. Partia Demokrate për Integritet e Prosperitet
12. Partia Lëvizja Punëtoresh Shqiptare
13. Partia e të Drejtave të Mohuara
14. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë
15. Partia Personat me Afërsi të Kufizuar
16. Partia Kombëtare Konservatore Albanian
17. Partia e Emigracionit Shqiptar
18. Partia Socialiste e Moderuar
19. Partia e Unitetit Kombëtar
20. Partia Kristian Demokrate
21. Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë
22. Partinë e Gjëlber



Media gjermane, "DW" shtron pyetjen nëse do ketë një minutë të fundit për opozitën

# Bojkoti i opozitës, Gjermania: Do t'i vëzhgojmë ne zgjedhjet

"Zgjedhjet e lira dhe të fshehta janë baza e çdo demokracie"

Në nëntor 2018, pas konsultimeve me partitë kryesore, Presidenti i Republikës, Ilir Meta nxori dekretin presidencial për zhvillimin e zgjedhjeve lokale në 30 qershor. Afrimi i kësaj date po ndodh në kohën kur situata politike në Shqipëri ka ndryshuar shumë nga nëntori i kaluar. Opozita është në sheshe dhe rrugë në protesta antiqeveritare. Në protestën e së shtunës, (13.04.2019), të karakterizuar nga akte dhune dhe përlëshje mes protestuesve dhe policisë, opozita vijoi qëndrimin e saj radikal. Lideri i PD-së, Basha, tha në fjalën përmbylëse të protestës, në orën 22:00 se, "largimi i Edi Ramës është kusht i panegociueshëm për qeveri transitorë, që do të përgatisë zgjedhjet e lira dhe të ndershme". Por, përtej deklaratave të tilla, opozita ka ndërmarrë veprime që lënë të kuptohet se edhe mund t'i bojkotojë zgjedhjet lokale të 30 qershorit. Opozita nuk dërgoi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, (KQZ) emrat e komisionerëve të saj zonale. Por përvoja e zgjedhjeve të mëparshme në situata ngërçesh dhe mosmarrëveshesh mes palëve ka treguar se komisionerët lokalë janë vendosur edhe në minutën e fundit. A do të ketë minutë të fundit kësaj here për komisionerët zonale të opozitës? Pikëpyetja ngrihet pas aplikimeve të qytetarëve për të zënë vendet vakante të opozitës për komisionerë zonale, pas thirrjes publike të KQZ-së.

**TRAJNIMI**  
Analistë të pavarur të Tiranës e kanë cilësuar "vetëvrasje politike" mospjesëmarrjen e opozitës në zgjedhjet lokale të 30 qershorit. Për më tepër kur në parlament po vijon marrja e mandatit të deputetit nga kandidatët për deputetë në listat e Partisë Demokratike (PD) dhe Lëvizjes Socialiste për Integritim (LSI), që nuk fituan në zgjedhjet parlamentare 2017. Kur të arrihet numri që parashikon ligji, deputetët opozitarë të sapohyrë në jetën parlamentare do të krijojnë grupet parlamentare opozitare për një jetë parlamentare sa më pranë normalitetit. Skenari i deritanishëm i bojkotit të zgjedhjeve nga të dyja partitë opozitare, PD dhe LSI,



## FINANCIIMI

Gjermania do të mbështesë financiarisht Shqipërinë në këtë proces vëzhgues përmes Komitetit Shqiptar të Helsinkit. Ambasadorja Schutz thekoi se, "mbështetja ndaj Komitetit Shqiptar të Helsinkit ka të bëjë me trajnimin e vëzhguesve dhe vëzhgimin real në qendrat e votimit, kontributin për zhvillimin e procesit zgjedhor sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare".

## SHKURT

### Bojkoti i opozitës, KZAZ-të u ngritën pa përfaqësues të PD-së dhe LSI-së

Administrata zgjedhore përgjegjëse për organizimin e zgjedhjeve lokale të 30 qershorit në Tiranë në terren është gati. 90 Komisionet Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve në 61 bashkitë kanë në përbërje përfaqësues të PS-së dhe anëtarë jopolitikë, të zgjedhur kryesisht nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi PD dhe LSI nuk e kanë dorëzuar listën e anëtarëve të tyre brenda afatit ligjor. Të premtën e shkuar u konstituan KZAZ-të në Tiranë e Durrës, ndërkohë që më parë ishin konstituar edhe në 56 bashki të tjera. Problematike është gjendja në bashkitë, Maliq, Himarë dhe Dropull.

## DATAT E AFATEVE PËR ZGJEDHJET

- 18 marsi ishte afati i fundit për propozimin e anëtarëve të KZAZ-ve. (Opozita nuk e ushtroi këtë drejtë, ç'ka e detyroi KQZ-në që komisionerët e saj t'i zëvendësojë me individë apolitikë).
- 21 prilli është afati i fundit për regjistrimin e partive politike në zgjedhje.
- 1 maji është afati i fundit për regjistrimin e koalicioneve në zgjedhje.
- 18 qershori është afati i fundit për propozimin e numëruesve të votave.
- 13 maji është afati i fundit për regjistrimin e kandidatëve për kryetarë bashkish dhe këshillat bashkiakë.
- 30 maji është afati i fundit për propozimin e anëtarëve të qendrave të votimit.
- 31 maji është afati i fillimit të fushatë zgjedhore.

## Afatet që kanë partitë politike për zgjedhjet e 30 qershorit

Përveç 21 prillit, që është afati i fundit për regjistrimin e partive politike në zgjedhje, Kodi Zgjedhor përcakton edhe një sërë afatesh të tjera të detyrueshme si për partitë që kanë përgjegjësi për administrimin e procesit, ashtu edhe për të gjitha partitë e tjera që duan të bëhen pjesë e zgjedhjeve vendore. Kështu, rreth 1 muaj më parë përfundoi afati i propozimit të komisionerëve për anëtar KZAZ-je, çka në mungesë të ardhjes së kandidatëve nga të gjitha forcat që kishin të drejtë të bënin propozime, KQZ-ja vendosi që një pjesë të tyre t'i plotësojë vetë, me in-



dividë që kanë aplikuar për komisionerë. Ndërkohë që një tjetër afat që rrezikon të shkelet nëse nuk gjendet një zgjidhje për krizën është ai i regjistrimit të koalicioneve. Sipas afateve që përcakton ligji zgjedhor, ato duhet të regjistrohen brenda datës 1 maj. Ndërkohë që

në 30 maj përfundon afati për anëtarë të qendrave të votimit dhe në 13 maj, depozitimi i emrave të kandidatëve për kryetarë bashkish. Sipas Kodit, depozitimi i listave shumëmbrore të kandidatëve për këshillat bashkiakë dhe kandidatëve për kryetarë bashkish duhet të bëhet jo më vonë se data 13 maj. Nëse partitë politike nuk e respektojnë këtë afat, ato do të çregjistrohen dhe nuk do figuronjë në fletën e votimit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka paralajmëruar partitë politike se nuk do të lejojë shkeljen e këtyre afateve dhe se do të marrë masa siç parashikohet në ligjin zgjedhor.

është kundërshtuar nga SHBA-të dhe BE-ja. Pas thirrjes së Zv.Ndihmës Sekretar të Shtetit, Matthew Palmer, drejtuar partive të opozitës për t'u riangazhuar në procesin politik, "sa më parë, përmes pjesëmarrjes në zgjedhjet lokale" është Gjermania, vendi më me peshe në BE, që adreson mesazhin e saj politik lidhur me zgjedhjet lokale.

## GJERMANIA

Ambasadorja gjermane në Tiranë, Susanne Schutz,

gjatë nënshkrimit të kontratës me Komitetin Shqiptar të Helsinkit për bashkëpunim në procesin e vëzhgimit të zgjedhjeve lokale tha: "U bëj thirrje të gjitha partive të shfrytëzojnë rastin e të marrin pjesë në zgjedhjet lokale". Ambasadorja Schutz thekoi se, "zgjedhjet e lira, të barabarta dhe të fshehta janë baza e çdo demokracie të shëndetshme. Është me rëndësi thelbësore që zgjedhëset/zgjedhësit të mund të kenë besim në një zhvillim të rreg-

ull të procesit zgjedhor". Gjermania do të mbështesë financiarisht Shqipërinë në këtë proces vëzhgues përmes Komitetit Shqiptar të Helsinkit. Ambasadorja Schutz thekoi se, "mbështetja ndaj Komitetit Shqiptar të Helsinkit ka të bëjë me trajnimin e vëzhguesve dhe vëzhgimin real në qendrat e votimit, kontributin për zhvillimin e procesit zgjedhor sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare".

Përlllogaritja, e bazuar në vitet e punës dhe pagën referuese

Voltiza Duro

Të gjithë ata individë që kanë dhënë kontributin e tyre dhe kanë punuar si ushtarakë në disa prej disa institucioneve të përcaktuara në ligj, kanë të drejtën e përfitimit të pensionit suplementar. Në faqen zyrtare të Institutit të Sigurimeve Shoqërore theksohet se kategoritë që mund të marrin këtë pagesë janë ushtarakët e Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, punonjësit e Policisë së Shtetit, punonjësit e Gardës, ata të Shërbimit Informativ të Shtetit e punonjësit e Policisë së Burgjeve. Gjithashtu, nga pensioni suplementar mund të përfitojnë edhe punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, ata të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm si dhe punonjësit e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

"Për efekt të përlllogaritjes së përfitimeve, viti i shërbimit njihet vetëm kur është vit i plotë. Në vjetërsinë në shërbim përfshihen edhe koha e ndërprerjes së karrierës, për shkak të një urdhri apo vendimi të padrejtë, të deklaruar me vendim gjykatë si dhe koha e plotë e vuajtjes së dënimit me burgim ose internim për motive politike, pas titullimit në karrierë nga personat që kanë shërbyer në strukturat e përcaktuara në këtë ligj, kur kanë përfitur sipas ligjit nr.7514, datë 30.9.1991 "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", - nënvizohet në ligj. Përfitimet që jepen për kategoritë e sipërpërmendura llogariten në bazë të pagës referuese, e cila përbëhet nga paga bazë mujore për gradë, sipas viteve të shërbimit dhe shtesat mbi pagë, ose nga paga bazë mujore për funksion dhe shtesat, të cilat përcaktohen e zbatohen për të njëjtën gradë apo në funksion me datën e lindjes së të drejtës së një përfitimi. Për efekt të përcaktimit të përfitimeve, paga referuese llogaritet si mesatare e pagave referuese, sipas viteve të qëndrimit në atë gradë apo funksion. Pagat referuese të njësuara dhe rregullat e llogaritjes së pagës mesatare referuese për të gjithë karrierën përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. ISSH gjithashtu bën me dije se pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi kanë të drejtë ta marrin burrat mbi 47 vjeç që kanë jo më pak se 15 vite shërbimi si dhe gratë mbi 42

# Pensionet e ushtarakëve, ja si bëhet llogaritja

## Kategoritë që përfitojnë dhe formula e saktë



### DOKUMENTACIONI

Personat e interesuar duhet të paraqiten në Agjencinë Lokale të Sigurimeve Shoqërore ku kanë vendbanimin dhe të pajisen me dy format kërkesë. "Një format-kërkesë e plotësuar paraqitet në strukturat nga ku kenë ndërprerë karrierën ushtarake dhe kenë dalë në rezervë/lirim apo pension pleqërie. Mbi bazë të kësaj kërkesë, këto struktura dërgojnë në rrugë postare modelarin nr.3 "Vërtetim për vjetërsinë në shërbim dhe pagën mesatare neto referuese" në strukturën rajonale të sigurimeve shoqërore, ku kenë vendbanimin", - citohet në faqen zyrtare të ISSH-së. Ndërkaq, formatit tjetër të



lindjes së të drejtës. Në rast të tjera, përfitimi paguhet nga data e paraqitjes së kërkesës për përfitim. Përveç kërkesës, të interesuarit duhet të bashkëngjijin edhe dokumentacionin përkatës. Kështu, për pension të parakohshëm, aplikanti duhet të dorëzojë edhe një fotokopje të kartës së identitetit, deklaratë për punësimin (e përvitshme), vërtetim nga Zyra e Tatim-Taksave, vërtetim nga zyrat e punës si punëkërkuar, vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive. Ndërsa për pensionin suplementar të pleqërisë dhe atë të invaliditetit, kandidati duhet të dorëzojë edhe një fotokopje të kartës së identitetit.

Forcat e Armatosura, punonjësi i Policisë së Shtetit, i Gardës, i Shërbimit Informativ të Shtetit, i Policisë së Burgjeve, i Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësi i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm për kohën që për arsye shëndetësore bëhen të paafët për punë, paafësi e cila vërtetohet me raport mjekësor, marrin përfitime suplementare", - citohet në nenin 8 të ligjit Nr.10/142. Ndërkohë, masa e përfitimit

suplementar për paafësi të përkohshme në punë llogaritet: 100 për qind e pagës referuese të muajit të fundit kalendarik të shërbimit, kur paafësia e përkohshme zgjat deri në 14 ditë, 20 për qind e pagës referuese të muajit të fundit kalendarik të shërbimit, nga dita e pesëmbëdhjetë e paafësisë e në vazhdim si dhe 10 për qind e pagës referuese të muajit të fundit kalendarik të shërbimit për periudhën e shtrimit në spital, kur përfituesi ka persona në ngarkim.

### KATEGORITË PËRFITUESE

1. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë: oficerë, nënofficerë, studentë ushtarakë dhe kursantë për nënofficerë, ushtarë me pagesë/profesionistë, ushtar i shërbimit të detyrueshëm, ushtarak në rezervë/lirim/pension pleqërie.
2. Punonjësit e Policisë së Shtetit kur janë aktivë, me pagesë kalimtare, në pension pleqërie, studentë kursantë dhe ushtarë (ndihmës agjentë).
3. Punonjësit e Gardës që gjenden në karrierë, punonjësit me status si kursantë, studentët dhe ushtarët, ish-punonjësit e Gardës, që janë në dispozicion në pritje për riemërim në detyrë dhe ish-punonjësit e Gardës, që kanë dalë në rezervë ose në lirim pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.8869, datë 25.3.2003 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të cilët trajtohen me pagesë kalimtare apo që kanë dalë në pension.
4. Punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit, në marrëdhënie pune me këtë shërbim, ata në lirim, me pagesë kalimtare, në pension, si dhe kursantët.
5. Punonjësit e Policisë së Burgjeve, kur janë aktivë, me pagesë kalimtare, në pension pleqërie, studentë kursantë dhe ushtarë (ndihmës agjentë).
6. Punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit.
7. Punonjësit e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm.
8. Anëtarët e familjeve të personave të përmendur në pikat 1-7 të këtij neni.

### DOKUMENTACIONI

#### Për pension të parakohshëm:

- Fotokopje e kartës së identitetit
- Deklaratë për punësimin (e përvitshme)
- Vërtetim nga Zyra e Tatim-Taksave
- Vërtetim nga zyrat e punës si punëkërkuar
- Vërtetim nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive

#### Për pensionin suplementar të pleqërisë:

- Fotokopje e kartës identitetit

#### Për pensionin suplementar të invaliditetit:

- Fotokopje e kartës identitetit

#### Për pensionin suplementar familjar:

- Certifikatë familjare
- Certifikatë e vdekjes së personit
- Fotokopje e kartës identitetit së përfituesit
- Vërtetim për vazhdimin e shkollës për jetimët që kanë mbushur moshën ligjore për t'u punësuar
- Deklaratë për punësimin apo aktivitetin ekonomik

#### Për pensionin suplementar familjar, kur ushtarakët humbasin jetën në detyrë apo për shkak të saj:

- Certifikatë familjare
- Certifikatë e vdekjes së personit
- Fotokopje e kartës së identitetit të përfituesit
- Vërtetim i vazhdimit të shkollës për jetimët
- Deklaratë për punësimin apo aktivitetin ekonomik

#### Njoftim shitje me ankand

Shoqëria përmbarimore "AA Baliff" shpk, zhvillon ankandin e III-të, për shitjen e pasurisë së paluajtshme, Trulli 310 m2 dhe ndërtesë 96 m2, me nr. pasurie 170/14, Vol. 8, Fq. 154, ZK. 3852, në pronësi të Ruzhdi Demir Tropolli e regjistruar në ZVRPP Durres. Çmimi i ankandit të trete është EUR 21,600 (njëzetë e një mijë e gjashtëqind euro). Ankandi zhvillohet dt. 10/05/2019, ora 16.00 në adresën Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27, Hyrja 1, Kati i III-të, Tiranë. Kontakt: cel. 0688012846, ose në adresën e email: aabaliff@gmail.com.

#### NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

#### ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 1/165+1-8/1, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 6, FAQE 179, SIPERFAQE 57 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. PËLLUMB META DHE ZNJ. RITAMETA. ÇMIMI 3.850.000 LEKE . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 09.05.2019. CEL. 0684026666 ; 0693262866 .



## Kapet me 9.5 kg kokainë, shqiptari dënohet me 12 vite burg

**D**rejtësia britanike ka dënuar me 12 vite burg një emigrant shqiptar, i cili në shtatorin e vitit të kaluar u arrestua me 9.5 kg kokainë të pastër. Siç raportojnë mediat lokale, i dënuari është Suad Sufaj, ndërsa pasi të kryejë dënimin, do të dëbohet menjëherë nga toka angleze. Shqiptari,

### DENIMI

Shqiptari, tashmë i burgosur, u arrestua vitin e kaluar në veri të Londrës dhe në makinë u gjet një 1 kg kokainë e pastër, element ky që shtoi dyshimet tek autoritetet. Pas kësaj, vijuan kontrollet edhe në shtëpinë ku jetonte i riu dhe prej aty u sekuestrua edhe pjesa tjetër të drogës.

tashmë i burgosur, u arrestua vitin e kaluar në veri të Londrës dhe në makinë u gjet një 1 kg kokainë e

pastër, element ky që shtoi dyshimet tek autoritetet. Pas kësaj, vijuan kontrollet edhe në shtëpinë ku jetonte i riu dhe prej aty u sekuestrua edhe pjesa tjetër të drogës. Nga përlogaritjet paraprake, mediat shkruajnë se nëse droga do të shitej në treg, do kapte shumë prej 1 milion sterlinash.



Kostoja e sasisë së sekuestruar llogaritet të tejkalojë 500.000 euro

# Mbollën kanabis në mes të Athinës, pranga 4 shqiptarëve

## Policët, të shokuar nga "shpikja" në Burnazi

**P**arcelë me 1000 rrënjë ujore kanabis ka zbuluar policia greke në qendër të Athinës, në zonën Burnazi, madje mes ndërtesave dhe zonës argëtuese plot me klube e bare. Policët grekë janë shokuar kur kanë hyrë në serat e kanabis, të ngjashme me një mini-Amazonë, siç janë shprehur pas operacionit. Pronarët e parcelës, 4 shqiptarë, dy 35-vjeçarë, një 37 dhe një tjetër 39 vjeç u arrestuan gjatë operacionit. Sipas policisë, shqiptarët kishin krijuar një laborator të plotë, me pajisje moderne dhe çdo aparaturë prodhimi e përpunimi, ndërsa ishin gati të nxirrnin në treg prodhimin e fundit. Gjithsej, policia greke sekuestroi 915 fidanë ujorë kanabis 10-70 cm, 2 kg e 580 gr kanabis bimor; laborator me të gjitha pajisjet për mbjelljen, prodhimin dhe përpunimin e drogës si dhe 4 celularë. Kostoja e sasisë së kanabis të sekuestruar llogaritet të tejkalojë 500.000 euro.



### NGJARJA

Parcelë me 1000 rrënjë ujore kanabis ka zbuluar policia greke në qendër të Athinës, në zonën Burnazi, madje mes ndërtesave dhe zonës argëtuese plot me klube e bare. Sipas policisë, shqiptarët kishin krijuar një laborator të plotë, me pajisje moderne dhe çdo aparaturë prodhimi e përpunimi, ndërsa ishin gati të nxirrnin në treg prodhimin e fundit.

## Lidhin mikrofonat me zinxhirë, gazetarët në protestë para Prokurorisë: Të shkarkohet...

**G**azetarë nga e gjithë Shqipëria janë mbledhur dhe në një protestë para Prokurorisë së Përgjithshme. Me pankarta në duar dhe me mikrofonat të lidhur me zinxhirë në formë simbolike, gazetarët protestojnë kundër intimidimit, kërcënimit dhe dhunës ndaj gazetarëve. Ata kanë shpërndarë edhe një njoftim, ku thuhet se lajmësi është i shenjtë dhe dënojnë aktet e rënda dhe të papranueshme të ndodhura së fundmi me punonjësit e medias.

### NJOFTIMI I GAZETARËVE

Gazetarët në protestë Ditën e premtë (12.04) rojet e sigurisë së prokurorisë së përgjithshme të Përkohshme, Arta Marku, ushtruan dhunë fizike ndaj gazetarit Renaldo Sallianji, gjatë kohës që po kryente detyrën e tij. Pak



ditë më parë, kryetari i Bashkisë së Pukës kërcënoi me "varje" gazetarin e emisionit investigativ "Fiks Fare", teksa ky i fundit kryente detyrën. Forcat e policisë penguan gazetarin Dorjana Bezat teksa raportonte live për shembjen e banesave tek "Bregu i Lumit". Dhuna policore qëllon mbi gazetarin Erjon Skëndaj gjatë raportimit të protestës së opozitës. Ko-

### LAJMËSI ËSHTË I SHENJTË!

Protesta është thirrur pas dhunimit të gazetarit të "Klan Plus", Renaldo Sallianji, i cili u shty nga truproja e Arta Markut. Ai ishte duke i drejtuar mikrofonin prokurorisë së përgjithshme, por nuk u lejua nga truproja. Po ashtu, edhe në protestën e opozitës të pak ditëve më parë, gazetari Erjon Skëndaj nuk u lejua që të raportonte dhe u ndalua nga uniformat blu.

muniteti i gazetarëve dënon këto akte të rënda dhe të papranueshme të ndodhura vetëm së fundmi me punonjësit e medias. Këto veprime cenojnë jo vetëm integritetin fizik të gazetarëve, por edhe lirinë e medias. Sot, gazetarët në Shqipëri po përballen me sulme fizike nga zyrtarët dhe njerëz të pushtetit, sikundër edhe me arrogancën institucionale, që shkel rëndë misionin e medias. Si reagim i fortë ndaj dhunës që kërcënon gazetarët, heshhtës së institucioneve përgjegjëse

për të dënur këto akte, kemi vendosur që ditën e diel ora 16:00-17:00 para Prokurorisë së Përgjithshme të protestojmë.

Ne kërkojmë shkarkimin e menjëhershëm të truprojes së Arta Markut dhe që Prokuroria e Përgjithshme të kërkojë falje për aktin e kryer. Ne kërkojmë zbatimin e ligjit për kryetarin e Bashkisë së Pukës. Ne kërkojmë të na lini të kryejmë detyrën tonë! Ne protestojmë për çdo akt që cenon lirinë e medias dhe gazetarit!

### SHKURT

## Shkrumbohet një automjet në Pogradec, e pësojnë edhe 3

Një automjet është djegur plotësisht gjatë natës në fshatin Starovë të Pogradecit, ndërsa e kanë pësuar edhe tri mjetet tjera, që ndodheshin pranë. Policia e Pogradecit bën të ditur se ngjarja ka ndodhur rreth orës 02:00 të mëngjesit, ku është djegur plotësisht një mjet tip "Benz" pronë e shtetases V.S.

Për shkak se kanë qenë afër, janë djegur pjesërisht 3 mjetet tjera, të cilat kanë qenë të parkuara brenda një karburanti. Nuk dihet nëse zjarri ka qenë për shkak të një defekti apo i qëllimshëm.



## Gramsh, digjet natën makina e policit

Një makinë e një efektivit të policisë është djegur gjatë natës në Gramsh. Automjeti tip "Benz" me targë GR1700B është në pronësi të shtetasit me iniciale Y.T., punonjës pranë Komisarariatit të Policisë Gramsh. Sipas burimeve të "BalkanWeb", automjeti ka qenë i parkuar pranë banesës së efektivit në lagjen "Sporti" dhe ende nuk dihen shkaqet e djegies së automjetit. Në vendngjarje kanë mbërritur forcat e policisë si dhe ato të kriminalistikës, të cilët po punojnë për zbardhjen e plotë të ngjarjes.

Policia: Kontrolli në pikën e dytë të kufirit zbuloi arkën me municione

# Arrestohet me 800 fishekë në kufi greku nga Janina

*Iu gjetën në makinën që drejtonte, akuzat*

Policia ka vënë në pranga sot një shtetas grek në Kakavijë, teksa po synonte të kalonte përmes pikës doganore një sasi të konsiderueshme municionesh luftarake. Pas kontrolleve, shtetasit grek me banim në Janinë iu gjetën në cilësinë e provës materiale 800 fishekë, të cilët i kishte fshehur në rroba. "Policia Kufitare godet një tentativë për trafik të armëve dhe municioneve luftarake. Arrestohet në flagrancë një shtetas grek, i cili tentoi të trafikonte për në shtetin grek një sasi të konsiderueshme municionesh luftarak. Sekuestrohen në cilësinë e provës materiale rreth 800 fishekë. Shërbimet e Policisë Kufitare në zbatim të masave për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e paligjshmërisë, si dhe në bazë të analizës së riskut, më datë 14.04.2019, në dalje të Republikës së Shqipërisë, kanë përzgjedhur për kontroll të imtësishëm në vijën e dytë një automjet që drejtohej nga shtetasi grek E.F., 49 vjeç, banues



në Janinë. Gjatë kontrollit të automjetit, shërbimet e Policisë Kufitare në PKK Kakavijë, në pjesën e brendshme të mjetit gjetën një arkë metalike të mbështjellë me rroba dhe një qese plastike, brenda së cilës kishte rreth 800 fishekë të kalibrit 7.62 mm. Fishekët u sekuestruan në cilësinë e provës materiale. Veprimet hetimore dhe procedurale të mëtejshme u kryen nga specialistët e Seksionit për Hetimin e Trafikeve në Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastër, të cilët bënë arrestimin në flagrancë të shtetasit grek E.F., për veprën penale 'Trafikimi i armëve dhe municionit', parashikuar nga neni 278/a i Kodit Penal', njofton policia.

## Dhunoit nënën e moshuar, pranga djalit në Fushë-Arrëz

Një 43-vjeçar është arrestuar dje në Fushë-Arrëz për veprën penale të dhunës në familje. Sipas policisë, në pranga ka përfunduar shtetasi Vladimir Kola, i cili për motive ende të pazbardhura ka dhunuar fizikisht nënën e tij. Ndërkohë "BalkanWeb" ka mësuar se ngjarje ka ndodhur në fshatin Fierz të Fushë-Arrëzit, ndërsa e moshuar V.Kola ka marrë hematoma në trup për shkak të goditjeve nga djali. Grupi hetimor kanë nisur punën për dokumentimin e plotë të rastit. Policia ka marrë në pyetje agresorin, i cili pritet të tregojë arsyet e vërteta të ushtrimit të dhunës.



# BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE  
LAJMET E FUNDIT NE  
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com  
**BW**

FALAS



Thaçi në Bruksel, zbardhen takimet e Presidentit të Kosovës

# Para samitit/ Presidenti Aleksandër Vuçiç: Më shqetëson takimi që do të bëhet në Berlin

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, dje ka udhëtuar për në Bruksel, ku do të zhvillojë takime me përfaqësues të lartë të Bashkimit Evropian. Kështu thuhet në komunikatën e dërguar nga Presidencia e Kosovës. Në kuadër të kësaj vizite, presidenti Thaçi do të takojë Presidentin e Këshillit Evropian, Donald Tusk, si dhe Komisionerin e BE-së për Zgjerim, Johannes Hahn. Presidenti Thaçi do të kërkojë nga liderët e BE-së vazhdim të mbështetjes dhe jetësim sa më të shpejtë të liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Në Bruksel, presidenti Thaçi do të flasë edhe për domosdoshmërinë e zhvillimit të agjendës së integritimeve evropiane për Ballkanin Perëndimor, si parakusht për sigurimin e paqes afatgjatë në Evropë. Ndërkaq, Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, ka thënë se është shumë i shqetësuar për gjithçka që po ndodh aktualisht si dhe për shkak të takimit të ardhshëm në Berlin. "Unë jam i shqetësuar për gjithçka, edhe për takimin në Berlin. Jo se kam frikë nga ndonjë presion, as nuk mendoj se do të ketë, por nuk po shoh se si dhe çfarë të bëj më tej

me njerëz aq të papërgjegjshëm, siç janë udhëheqësit shqiptarë sot. Kjo është ajo që shkakton shqetësim të madh, por kjo do të na shtyjë të sillemi në mënyrë më serioze dhe më të përgjegjshme", tha dje Vuçiç. Siç raportojnë mediat serbe, Vuçiç ka thënë se ka parë se sa shumë vëmendje dhe pritje i kishin dhënë mediat shqiptare asaj që ndodhi të shtunën në rrugët e Beogradit (protesta e opozitës kundër presidentit serb) dhe se, "mediat e Thaçit dhe Haradinajt i janë gëzuar asaj që potencialisht pritet t'i ndodhë atij". "Kjo më dha forcë dhe shpresë se po bëj gjëra të mira për vendin tonë dhe njerëzit tanë në Kosovë", tha presidenti. Ai shtoi se mediat shqiptare, ndryshe nga ato gjermane, zvicerane dhe kroate, i panë gjërat nëpër rrugë me një mënyrë tjetër. Dy



Presidenti Thaçi në një nga takimet me Aleksandër Vuçiç

shtetet më të fuqishme të Bashkimit Evropian, Gjermania dhe Franca kanë vendosur të mbledhin në Berlin më 29 prill udhëheqësit e Ballkan-

it Perëndimor, përfshirë këtu edhe Presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi dhe atë serb, Aleksandër Vuçiç. Samiti do ta ketë theksin të bash-

këpunimi rajonal, por një nga qëllimet kryesore të këtij takimi duket se do të jetë fillimi i dialogut mes Kosovës dhe Serbisë.

## ALEKSANDËR VUÇIÇ

"Unë jam i shqetësuar për gjithçka, por dhe për takimin në Berlin. Jo se kam frikë nga ndonjë presion, as nuk mendoj se do të ketë, por nuk po shoh se si dhe çfarë mund të bëj më tej me njerëz të papërgjegjshëm, siç janë udhëheqësit shqiptarë sot. Kjo është ajo që shkakton shqetësim, por do të na shtyjë të sillemi në mënyrë më serioze dhe më të përgjegjshme", tha Vuçiç.

## Akuzat për abuzim seksual, e vërteta e odisesë nga arratisja te kapja

Nga Oliver Kamm

# Julian Assange nuk është një hero i fjalës së lirë

## Historiku i bashkëthemeluesit të "Wikileaks"

Assange nuk është asnjë hero i fjalës së lirë dhe as një rebel kundër pushtetit shtetëror. Ai është një i dyshuar penal, që qëndroi i fshehur në mënyrë të paligjshme dhe që tashmë është arrestuar, akuzuar dhe shpallur fajtor. Saga personale e tij pasqyrohet edhe nga rënia e rolit të "WikiLeaks", që ai e krijoi në vitin 2006. Ai nuk ishte një operacion fisnik, që do të zbulonte krimet e plotfuqishmëve, por një instrument i qeverive të huaja represive dhe një kanal për propagandën e tyre. Historia e zymtë e Assange është një rekord i përpjekjeve serioze për të penguar sundimin e ligjit. Ai e ka shpallur veten viktimë të një pezullimit të një procesi të rregullt ligjor, por në të vërtetë është një i arratisur prej tij. Assange kërkoi të shmangë një urdhër-arrest të vlefshëm ndërkombëtar, të cilin pati mundësinë ta sfidonte në Suedi dhe Britani. Rasti i tij u konsiderua me përpikmëri nga Gjykata e Lartë. Ai zgjodhi të largohet dhe fshehet, në vend që të përgjigjej përballë akuzave për krime të rënda. Avoka-

tët suedeze që përfaqësojnë palën paditëse kanë paraqitur sot një kërkesë në zyrën e prokurorisë që të rifillojë hetimi paraprak ndaj Assange. Kjo është më e pakta që mund të bëhet për të kënaqur nevojën për drejtësi për viktimat e supozuara të tij. Departamenti Amerikan i Drejtësisë ka njoftuar një akuzë penale kundër Assange, duke e akuzuar atë për komplot, së bashku me ish-analistin e zbulimit, Chelsea Manning, duke hakëruar të dhëna të ndjeshme nga një kompjuter i qeveritar. Megjithatë, SHBA-të duhet të demonstrojnë arsye të forta se përse duhet kryer ekstraditim. "Mitologjia" rreth Assange, që e përshkruan atë si një luftëtar heroik kundër shtypjes shtetërore nuk mund të jetë më larg të vërtetës. Sikur ai të kishte realisht frikë për jetën e tij si pasojë e ekstradimit



Julian Assange

në SHBA, do të pranonte të ballafaqohej me akuzat në Suedi, vend që detyrohet nga ligjet e BE-së dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut të mos ekstradojë asnjë person, aty ku ekziston rreziku i një dënimi me vdekje. Në vend të kësaj, ai zgjodhi arratinë. Burracakëria dhe arroganca janë në karakterin e tij. "WikiLeaks" pati fillimisht reputacionin e një organizate të fjalës së lirë, me miliona dokumentet

sekrete të publikuara, duke përfshirë qindra mijëra kabilograme diplomatike amerikane. Ndër zbulimet e tij, ishte regjistrimi i një sulmi ajror amerikan, që vrau disa gazetarë irakianë. Një investigim nga agjencia e lajmeve "Associated Press" zbuloi se "WikiLeaks" kishte dështuar të censuronte emrat e viktimave të përdhunimit dhe abuzimit seksual, si dhe të sëmuretë mendore. Kohët e fundit

"WikiLeaks" është zhytur në atë që mund të konsiderohet vetëm si një fushatë propagandistike nga autokracitë e huaja kundër Perëndimit. Sipas inteligjencës perëndimore, ajo luajti një rol vendimtar në ndërhyrjen ruse në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016. Dy rrjedhje informacioni që dëmtoan Hilari Clinton dhe vjedhja nga hakërat rusë rezultuan vendimtare në atë fushatë. Të paktën ata bënë të mundur që Donald Trump të shmangte vëmendjen nga arroganca dhe sulmet e tij ndaj grave. Përkimi i momentit sugjeroi më së paku mundësinë e një komploti. Politikat antiamerikane të "WikiLeaks"-it e vendosën atë në anën e Rusisë dhe të lajmeve të rreme të "Russia Today" dhe "Sputnik". Dhe ka ku jemi. Një njeri që ishte dikur në qielli e shtatë, në fund është kapur dhe është

të gati të përballlet me drejtësinë. Organizata që ka themeluar ai ka treguar me vetëdije që çdo reputacion që kishte për rrëfim e të vërtetës, ishte i keqgjuptuar. Paditëset kundër Assange meritojnë një përgjigje, dhe jo vetëm prej tij. Gjatë gjithë kësaj farse të zymtë, disa figura të errëta kanë vepruar si të plotfuqishëm në emër të Assange dhe nuk është shumë e vështirë të sugjerohet që tani ata do e mbrojnë Xhorxh Gallouej, sugjeron se Assange në rastin më të keq do të shpallet fajtor vetëm për "sjellje të keqe seksuale". Vogan Smith, themeluesi i klubit të Gazetarëve të Frontit të Parë e vlerësoi Assange dhe mbrojti vendimin e tij në një deklaratë, që nuk përmendi në asnjë rast gratë që miku i tij dyshohet se ka sulmuar seksualisht. (Është një akt i vogël simbolik, por kjo më detyroi të jap dorëheqjen nga anëtarësia në këtë klub.) "Lërimi gjykimin të rrjedhë si ujërat dhe drejtësinë si një përrua i madh", thotë libri i Aмосit në Bibël. Për Assange dhe për gratë që nuk kanë guxuar të heqin dorë nga lufta e tyre për drejtësi, kjo nuk do të ndodhte para se vinte koha.

Marrë nga "Bota.al"

## Më në fund Dafina Zeqiri publikon këngën e re

Më në fund erdhi kënga që të gjithë fansat prisnin. "Rofe" titullohet kënga më e re e Dafina Zeqirit. Këngëtarja e publikoi si projekt dje me rastin e ditëlindjes së saj, si dhuratë për të gjithë ata që adhurojnë muzikën e saj. Dafina punoi me 'Cricket' dhe 'BledBeats' për muzikën, ndërkaq për tekstin u përkujdes vetë ajo, në bashkëpunim me Arianit Palajn. E sigurt që edhe kjo do të jetë hit si të gjithë këngët e mëparshme të Dafit.



## 'Single' apo e lidhur? Tayna përgjigjet më në fund

Gjatë një paraqitje në "E diell", reperja e njohur Tayna u pyet nëse është në lidhje me dikë dhe ajo u përgjigj shkurt. "Jo", tha Tayna duke cituar më pas edhe një pjesë të këngës së saj "Pow Pow". Kënga e fundit e Taynës është "Kce", e cila ka arritur më shumë se 10 milionë klikime në "Youtube". Pas këtij sukcesi, ajo nuk ka të ndalur, pasi përmes rrjeteve sociale ka paralajmëruar një verë të nxehtë me projekte të reja.



## "Ulërima dhe mallëngjim", Roza Lati tregon si reagoi e ëma kur mori vesh për herën e saj të parë

Moderatorja Roza Lati dhe aktorja e humorit Rita Lati kanë një lidhje shumë të afërt si nënë e bijë. Gjithmonë kanë folur për raportin e tyre të ngushtë, madje edhe për gjërat më intime. Të ftuara në "Xing"



me Ermal Mamaqin, Roza zbuloi se si ka reaguar e ëma kur mori vesh për herën e saj të parë. "Rita Lati ka tri emocione të ndryshme për tri sekonda. Emocioni i parë, ulëriti; emocion i dytë, u mërzi; emocion i tretë, u mallëngjye. Goca ime është bërë vajzë e rritur tha dhe doli nga shtëpia. Pas 15 minutash erdhi me një tortë", - tregoi Roza për reagimin e




## Një vit larg ekranit, Marina Vjollca kthehet me projektin e ri

Pas përfundimit të emisionit "C'est la vie" në janar të vitit të kaluar, Marina Vjollca u përfol gjatë për mungesën në ekran. Largimi i saj nga ekran i përkoj me martesën me reperin Getoar Selimi. U tha se ishte bashkëshorti, që nuk e lejonte të kthehej në ekran, por zërat u përgënjeshtruan.



Mirëpo, duket se moderatorja gjatë kësaj kohe ka qenë duke punuar për një projekt të ri dhe ka njoftuar kthimin e saj me anë të një postimi. Thuhet se ajo do të drejtojë një program talentesh.





## YLLI MERJA:



Si të humbisni peshë  
brenda një kohe  
të shkurtër

## KESHILLA



Si ta përdorni  
kafenë për trajtimet  
e flokëve dhe lëkurës

## VIKTOR QERESHNIKU:



Mjeku i përgjithshëm:  
Disa këshilla efektive  
për të mbrojtur  
shëndetin



## Kujdes, sëmundjet që shkaktojnë valët elektromagnetike

"Sa kancerogjene  
janë aparatet celulare"

## Luftoni sëmundjet kardiovaskulare me lëngun e karotës

Mjeku i përgjithshëm: Disa këshilla efektive për të mbrojtur shëndetin

Voltiza Duro

Në jetën tonë të përditshme, ne ndeshemi me valë të shumëllojshme, ndaj të cilave organizmi reagon në mënyra të ndryshme. Valët e detit zakonisht kanë një efekt relaksues mbi organizmin human, e kundërta ndodh me valët elektromagnetike. Përveç valëve të dritës, në shpëtitë tona hyjnë edhe valët të prodhuara artificialisht si nga stacionet e radios, televizorët, telefonat celularë, kompjuterat dhe të tjera. Të gjitha këto valë transmetojnë energji, secila në masë më të madhe apo më të vogël. Efekti i tyre mbi organizmin tonë është i ndryshëm (sepse janë valë me karakteristika të ndryshme).

**Antenat e ripërtitorëve të TV-së, radios dhe telefonave celularë, a janë të dëmshme?**

Potencia e një ripërtitori të telefonisë së lëvizshme është shumë më e madhe se ajo e një celulari. Por, nëse telefoni celular do të vendoset anash kokës, kjo do të shkaktojë nxehtësi nga vetë aparati dhe praktikisht bëhet më e dëmshme se ajo e ripërtitorit.

Problemi i elektromagnetizmit qëndron, sepse është një ndotje e "padukshme", "nuk ka erë", por që shkakton rrezatim elektromagnetik, veçanërisht të rëndë dhe të dëmshëm, duke rrezikuar për tumore, sidomos te fëmijët, dhe ky problem me ndërgjegje harrohet nga të gjithë, sepse të gjithë jemi përdorues të kësaj teknologjie (qoftë edhe duke përdorur celularin). "Nëse zhvillimi ekonomik duhet të realizohet me fondet e Shëndetit Publik, kjo rrezikon që të fitohet djoka sot, duke shtuar shpenzimet socio-sanitare në të ardhmen, si pasojë e shtimit të rasteve të kancerit, çrregullimeve neurodegenerative, infertilitetit, pagjumësisë, depresionit, alergjive dhe të gjitha problemeve të lidhura me radiofrekuencat".

Shtimi i antenave të ripërtitorëve të frekuencave, me të vërtetë që të bën të lidhesh më shpejt me internetin, televizorin, stacionet e radios dhe të tjera, por kjo mund të bëjë që të shtohet problemi i sëmundshmërisë. Këtë kanë nënvizuar presidentët e Agjencisë Rajonale për Ambientin dhe të Institutit të Lartë për Kërkimet Ambientale në Itali, në nëntor 2011. Studimet e viteve të fundit kanë vënë në dukje se valët e padukshme të spektrit elektromagnetik kanë një ndikim të thellë mbi çdo aspekt të rreg-

# VIKTOR QERESHNIKU:

## Kujdes, sëmundjet që shkaktojnë valët elektromagnetike

*"Sa kancerogjene janë aparatet celulare"*



Mjeku Viktor Qereshniku

ullimit biologjik. Funksionet biologjike të organizmit tonë (të rrahurat e zemrës, funksionimi i trurit, reaksionet metabolike që ndodhin në çdo qelizë etj.), rregullohen nga rryma, pra ne jemi "genie elektrike". Në botën e qytetëruar ne ndodhemi në një ekspozim të pandërprerë ndaj valëve elektromagnetike, që çlirohen nga pajisjet elektrike të përdorimit të përditshëm si frigoriferë, televizorë, telefona celularë, kompjuter, "Wi-Fi" etj., dhe si pasojë detyrimisht që predispozohemi me pasojat shëndetësore të një lloji apo tjetri, nga veprimi i këtyre valëve.

Sipas dr. Ann Louise Gittleman, autore e librit "Zapped", ne jemi të ekspozuar ndaj nivelit rrezatimit radioaktiv për 100 milionë herë më shumë se stërgjyshërit tanë.

Hulumtuesit në Institutin Kombëtar për Shëndetësi kanë zbuluar se thjesht vetëm mbajtja e një celulari aktiv afër kokës për 50 minuta prodhon ndryshime të dukshme në metabolizmin e trurit.

Raporti komplet është prezantuar së fundi nga prof. Girish Kumar i departamentit IT të 'Bombay', të inxhinierisë elektrike. Kumar ka thelluar kërkimet e tij mbi rrezatimin e telefonisë celulare dhe efektet e saj. Është kundër përdorimit të shpeshtë të telefonave celularë, sepse u sh-

kakton përdoruesve shtimin e riskut të kancerit, tumoreve të trurit dhe rrezeje të shumta të tjera për shëndetin. Për fëmijët, kjo është edhe më e shprehur. "Wi-fi" (interneti pa fije) është një sistem që krijon fushë elektromagnetike me një frekuencë rreth 2400 megaherc, gati e barabartë me atë që organizmi absorbon edhe nga celulari.

**Valët e emetuara nga telefonat celularë a shkaktojnë kancer?** Fjalë mbi këtë pyetje ka shumë, por pak mund të quhen informacione apo fakte minimalisht të kënaqshme. Paolo Vecchia në Institutin e Lartë të Shëndetit, Romë, ka krijuar klasifikimin e quajtur IARC për vlerësimin e aftësisë kancerogjene të fushave elektromagnetike.

**Klasifikimi sipas IARC:**

Agjent kancerogjen për njeriun.  
a) Agjent probabilisht kancerogjen për njeriun.  
b) Agjent i mundshëm kancerogjen për njeriun.  
Agjent jo i klasifikueshëm përse i përket kancerogjenitetit të njeriut.

Agjent probabilisht jokancerogjen për njeriun. IARC i ka klasifikuar fushat magnetike ELF si të mundshme kancerogjene për njeriun (Grupi 2B).

**Efektet e tjerë të shkaktuara nga cilado fushë radiofrekuence:**

Absorbim të energjisë elektro-

magnetike. Shpërndarje në formën e nxehtësisë.

Ngritje e temperaturës së përgjithshme apo lokale (efekti termik). Shkenca mjekësore e konsideron si të tolerueshme një ngritje konstante të temperaturës deri në 1 gradë celsius, që korrespondon me një vlerë prej 4W/kg.

**Efektet e tjera të valëve elektromagnetike:**

Frekuencat elektromagnetike influencojnë mbi ADN-në, RNA-në dhe mbi sintezën e proteinave, duke çrregulluar formën dhe funksionin e proteinave dhe influencojnë mbi gjenet, në ndarjet dhe diferencimin qelizor, në morfogjenezën (procesi me anë të të cilit qelizat duke u grumbul-

luar formojnë indet dhe organet), mbi sekrecionet hormonale si edhe mbi zhvillimin dhe funksionimin e sistemit nervor. Sasia e energjisë që celulari emeton varet nga modeli i aparatit, nga teknologjia, por mbi të gjitha nga distanca mes telefonit dhe antenës, apo ripërtitorit (përsëritësit) të sinjalit. Sa më larg të jetë nga antena, aq më shumë duhet të rritet fuqia për të stabilizuar komunikimin, pra për të "pasur rrjet". Po ashtu, kur telefoni gjendet brenda një strukture metalike, kjo mund të shërbejë si izoluese dhe energjia e emetuar të jetë më e madhe. Një rast konkret është ai i makinës, skeleti metalik i së cilës rrit energjinë e emetuar nga telefoni celular.

**ÇFARË MUND TË BËJME QË TA MBROJMË VETEN?**

**Të mos mbahet telefoni celular afër, nën jastëk, gjatë gjumit.**

**Të shkurtohet koha dhe numri i telefonatave që bën duke përdorur telefonin celular.**

**Të përdoren kufjet, sepse edhe me disa centimetra distancë, fusha elektromagnetike bie dukshëm në intensitet.**

**Të mbahet celulari sa më larg të jetë e mundur nga koka. Shkruaj SMS (mesazhi) ose përdor altoparantën e celularit sa më shpesh.**

**Në shtëpi të përdoren telefona me tela, të modës së vjetër, në vend të atyre bashkëkohorë pa tela.**

**Të mbahet laptopi larg nga prehri, të vendoset në tavolinë.**

**Të largohen të gjitha, apo shumica e pajisjeve elektrike nga dhoma e fjetjes.**

**Të konsumohen super-ushqime dhe suplementare antioksidues, për të luftuar radikalet e lira që valët elektromagnetike krijojnë.**

**Të përdoret teknologji tokëzimi për të stabilizuar ritmet elektrike të trupit dhe minimizuar efektet e interferencës së frekuencave elektromagnetike.**

**Të mos qëndrohet gjatë pranë antenave të ripërtitorëve. Largësia nga këto antena varet nga frekuencat që ato emetojnë. Sidoqoftë, mirë është që këto antena të mos jenë pranë zonave të banuara.**

**Duke implementuar këto dhe disa strategji të tjera, dr. Gittleman pretendon se ka arritur përmirësime të mëdha në shëndetin e saj, si dhe në shëndetin e njerëzve tjerë që ajo ka ndihmuar.**



Voltiza Duro

**J**etojmë në një kohë që nga njëra anë ka bollëk të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale, por njëkohësisht jemi edhe në një fazë që ne nuk dimë realisht origjinën e prodhimit të ushqimeve që konsumojmë. Pra, këto produkte mund të jenë me ndërhyrje të shumta kimike, apo hormone, apo me përqindje të lartë të sheqernave, sidomos tek ëmbëlsirat. Kjo sasi e lartë karbohidratesh apo sheqernash përdoret për të mos shkaktuar dëmtimin, prishjen e këtyre produkteve të ëmbëltove deri sa të shkojë te konsumatori. Por, që të dy faktorët e sipërpërmendur ndikojnë në atë që quhet depozitim i rezervave ushqimore në organizëm e ky i fundit fillon që këto karbohidrate t'i kthejë në dhjamë e t'i ruajë. Pra, këto depozitime nuk janë asgjë tjetër veçse një energji e pakonsumuar nga organizmi. Nëse arrijmë t'i djegim të gjitha kaloritë që marrim gjatë ditës, atëherë pesha trupore mbetet e pandryshuar, por kur marrim kalori më shumë se sa harxhojmë, organizmi fillon t'i depozitojë në formën e dhjamit, kryesisht në pjesën e barkut ose edhe në zonën glutuale apo kofshë. Kështu, që të kemi parasysh peshën normale të trupit, duhet të ndajmë dy faza: faza e rritjes së fëmijëve (ritija metabolike e tyre) dhe faza e qëndrimit standard të peshës trupore të të rriturit. Nëse fëmijëve duhet t'u japim kalori më shumë sesa ata djegin për shkak se kalojnë në fazën e tyre të zhvillimit, duhet të mos harrojmë që mund t'i japim të konsumojnë edhe ushqime që përmbajnë yndyra nga 2-4%, ndërsa produkte shtazore mund t'u japim 50-100gramë, kurse ushqimet që përmbajnë karbohidrate duhet të jenë në raportin 1:4 me sasinë e proteinave që marrin.

**INDEKSI I MASËS TRUPORE** Në të dyja rastet, qoftë të fëmijët në rritje apo te vetë të rriturit duhet të kemi parasysh që herë pas herë të kontrollojmë indeksin e peshës trupore ose masën trupore (treguesi IMT) që bazohet në gjatësinë dhe peshën trupore. Nëse një i rritur mat peshën e trupit dhe e pjesëton me katrorin e gjatësisë së tij në metra, rezultati do të tregojë indeksin e masës trupore. Nëse ky i fundit është më i vogël se 20, atëherë individi ka një peshë ideale dhe nuk është i prekur nga sëmundjet kardiovaskulare. Nëse ky indeks është

Mjeku popullor: Pse është i rrezikshëm obeziteti abdominal, pasojat

# YLLI MERJA:

## Si të humbisni peshë brenda një kohe të shkurtër

*"Përdorni limon, ujë dhe mjaltë"*



Ylli Merja

të 20-25, atëherë mund të themi që individi është brenda një peshe normale, por në fillosat e një obeziteti. Kur IMT rezulton 25-30, atëherë kemi të bëjmë me mbipeshë e kur parametri del mbi 30, individi vuan nga obeziteti. Kjo formulë vlen pothuajse për të gjitha moshat, edhe për fëmijët. Nëse te këta të fundit IMT del më tepër se 30, prindërit duhet të marrin masa e t'i ndërpresin të gjitha ushqimet që përmbajnë sheqerna, duhet t'i pakësojnë ushqimet shtazore që përmbajnë dhjamëra (yndyrë) si dhe të fillojnë të mësojnë fëmijën me aktivitet fizik. Një tregues tjetër që

përcakton obezitetin është cirkunferenca e mesit (gjatësia e rripit të mesit) e kjo matet me një metër e nëse rezultatet dalin më shumë se 100, atëherë personi ka depozitime të dhjamit në zonën e stomakut, i njohur ndryshe si obeziteti abdominal. Ky i fundit është shumë më i rrezikshëm për shëndetin se dhjami që gjendet në regjionet glutuale ose në kofshë. Pra, matja e cirkunferencës së mesit jep informacione të rëndësishme rreth rrezikut të problemeve të zemrës, për presionin e lartë të gjakut, kolesterolin e lartë, diabetin e tipit të dytë. Ky


parametër të meshkujt nuk duhet të shkojë më shumë se 100, ndërsa te femrat jo më shumë se 80-85 centimetra, kjo gjithmonë në varësi të gjatësisë. Një tregues tjetër i obezitetit është edhe sindromi metabolik, trajtimi i të cilit duhet të bëhet i gërshtuar me aktivitetet fizike si dhe me pakësimin e sasisë së ushqimeve. Gjithashtu, duhet të ndërpritet edhe alkooli. Ky grup njerëzish duhet të arrijë të ulë peshën trupore me 10 gramë në ditë.

**TRAJTIMI NATYRAL**

Personat mbipeshë duhet të mos konsumojë lëngjet e konservuara të frutave apo pijet me gaz dhe së paku ta zëvendësojnë me ujë natyral si dhe 1-2 gota çaj të gjelbër në ditë, një limon të shtrydhur si dhe 5-6 fije majdanos në ditë. Edhe lëvorja e limonit është shumë efektive për rënie në peshë, ku brenda 25 ditëve shihen rezultate. Kur personi ka diabet dhe kolesterol të lartë, duhet patjetër të synojë rënie në peshë, pra duhet t'i shpallë luftë të "heshtur" mbipeshës së trupit të tij e të bjerë minimalisht 200-300 gramë në një javë. Gjithashtu, të mos konsumojë më bukë të bardhë, por ta zëvendësojë me produktet bimore që kanë fibra, veçanërisht thekëra. Nëse obeziteti i fëmijëve bëhet shqetësues, atëherë du-



het të mbahet nën kontroll sasia e ushqimeve si dhe ta shtyjim fëmijën që të merret me ushtrime fizike, por edhe me basketboll. Një person është obez, së paku duhet të rregullojë tretjen duke pirë 1-2 gota ujë të ngrontë në mëngjes, të shoqëruar me një lugë kafe mjaltë dhe gjysmë luge kafe piperi të zi. Mjalti arrin të gjallërojë punën e enzimave në organizëm, të largojë toksinat dhe të nxitë funksionin e jashtëqitjes. Gjithashtu, për të gjithë personat mbipeshë këshillohet të konsumojnë 3-5 vakte duke ngrënë patjetër mëngjesin çdo ditë. Edhe çaji me dëllinjën e zezë i kombinuar me bishtat e qershisë ndihmon në largimin e ujit të tepërt nga organizmi. Një mënyrë tjetër për rënie në peshë është edhe përdorimi i çajit natyral për dobësim, e kjo përzierje bimësh do të ndihmojë edhe sistemin e tretjes dhe në jashtëqitje. Ky çaj që përmban edhe mëshëknë bën që uji i tepërt të largohet nga organizmi, pa larguar kripërat minerale.

*Njerëzit në të gjithë botën e duan kafënë, jo vetëm për shijen e mirë, por edhe për përfitimet shëndetësore që ka. Mund të çuditeni, por kjo pije kaq popullore mund t'iu ndihmojë edhe për trajtime bukurie dhe për flokë. Më poshtë janë disa receta shumë efektive me kafe për mirëmbajtjen e flokëve dhe lëkurës.*



**ENJTJE POSHTË SYVE**  
Përzieri gjysmë luge gjelle të kokrrave të freskëta të kafesë, ose kafesë së bluar me gjysmë luge së gjelle vaj kokosi, shtoni pak piper të zi dhe disa pika ujë. Vendosni këtë maskë në pjesën e poshtme syve. Pasi maska të thahet, pastrojeni fytyrën me ujë të vakët.

## Si ta përdorni kafënë për trajtimet e flokëve dhe lëkurës



**RËNIA E FLOKËVE**  
Përzieri dy lugë gjelle të kafesë së pjekur mesatarisht me 100 ml të vajit të ullirit, të nxehur paraprakisht. Vendoseni këtë maskë në flokë të lagura. Shpërndajeni maskën në gjithë gjatësinë e flokëve dhe mbështillni më pas flokët me letër alumini. Pas 30 minutash, lani flokët me shampo. Aplikojeni këtë maskë 1-2 herë në javë. I gjithë trajtimi i flokëve tuaj me këtë maskë duhet të përfundojë pas 12 herësh.



**CELULITI**  
Përzieri kafënë e pjekur ose kokrrat e saj me sasinë e njëjtë të kripës, ndërsa më pas shtoni disa pika të vajit të ullirit. Avullojeni lëkurën fillimisht, më pas vendoseni këtë skrab dhe masazhoni fytyrën me lëvizje rrethore. Këtë procedurë duhet ta përsërisni 1-2 herë në javë.



# Këshilla



## Luftoni sëmundjet kardiovaskulare me lëngun e karotës

**K**arota u kultivua për herë të parë në Afganistan dhe ishte e njohur që në lashtësi. Mjeku i lashtësisë, Hipokrati, e përdorte atë si tonifikues për stomakun dhe sistemin tretës. Gjatë viteve '60, disa shkencëtarë rusë zbuluan te karota një substancë të quajtur Daucarine, e cila kishte aftësinë të zgjeronte enët e gjakut, sidomos në zonën e kokës, duke ndihmuar kështu në evitimin e episodeve kardiake. Në Rusi akoma edhe sot mjekët u këshillojnë pacientëve lëng karote me mjaltë për të luftuar kollën dhe të ftohtin. Karota është mjaltë e pasur në vitamina A, B dhe C, si edhe substanca minerale mjaltë të çmuara për organizmin. Ajo përmban një substancë të quajtur b-karoten, e cila përmirëson shikimin. Konsumimi i shpeshtë i karotave është i nevojshëm, sidomos për ata persona që vuajnë nga lodhja, dobësia dhe stresi. Karota ndihmon gjithashtu në rritjen dhe zhvillimin e energjisë e vitalitetit të adoleshentëve. Hekuri që ajo përmban rrit nivelet e hemoglobinës në gjak, duke luftu-

ar aneminë. Kërkimet e fundit kanë provuar se substanca b-karoten mund të ndërpresë veprimtarinë e tumoreve, sidomos të mushkërive dhe pankreasit. Dieta me supë karotash është mjaltë e mirë për pastrimin e mëlçisë. Vetitë kuruese të karotës

- Karota hap oreksin dhe rrit sekretimin e lëngjeve gastrike. Është një terapi mjaltë e mirë kundër koleritit, irritimeve të zorrëve dhe ulçerave të stomakut.
- Aftësitë diuretike të karotës e mbrojnë fshikëzën e urinës nga infeksionet.
- Karota ka aftësi dizintoksikuese, të cilat ndihmojnë

ata persona që vuajnë nga aknet në fytyrë dhe ekzemat.

- Një veti e mrekullueshme e lëngut të karotës është se ai ndihmon në jashtëqitjen e sekrecioneve të mushkërive (gëlbazave), duke e lehtësuar kështu organizmin në raste bronkitesh apo gripi.
- Një gotë lëng karotash gjysmë ore para mëngjesit, ndihmon organizmin e fëmijëve që vuajnë nga parazitët e zorrëve.
- 1-2 karota në ditë ul kolesterolin e gjakut në 10%, duke ndihmuar në mbrojtjen e organizmit nga tensioni dhe sëmundjet kardiovaskulare.
- Karota ka edhe një tjetër të mirë, pasi i fal shëndet dhe gjallëri lëkurës.



## Vlerat ushqyese të kompostos së kumbullës, receta e përgatitjes

Kompostojta është një traditë mjaltë e hershme shqiptare. Ajo përbën mënyrën më popullore për të ruajtur ose shtuar vlerat e frutave. Përgatitja e kompostos është mjaltë e thjeshtë. Duhet ujë, pak sheqer dhe fruta. Ndonjëherë sheqeri mund të zëvendësohet me mjaltë për ta bërë lëngun më të shëndetshëm. Në vendin tonë, kompostoja më popullore është ajo e kumbullës, por tradita jonë nuk është e kufizuar vetëm tek kumbulla. Molla, dardha, rrushi, portokalli, qershitë, shagët, petalet e trëndafilit e të tjera përdoren gjerësisht si komposto. Ajo mund të shërbehet si lëng freskues, ndërkohë që mund të ofrohet edhe si ëmbëlsirë. Çdo komposto, sidomos ajo e bërë në shtëpi, në përmbytjen e saj ka fruta, mjaltë, kanellë dhe karafil, produkte që e bëjnë këtë lëng të këshillueshëm për këdo. Mjalti dhe frutat së bashku janë shumë më të shëndetshme për ju se sa ëmbëlsirat, akulloret, apo lëngjet e gazuara. Mënyra më e mirë për të përfutur vlerat e frutave dhe të mjaltit te kompostojta është që pas procesit të zierjes, të lejoni lëngun të ftohet për minimalisht një orë. Lexoni më poshtë recetën e sugjeruar për komposton e kumbullave.

### PËRBËRËSIT

- 1 kg kumbulla
- 1/2 kg sheqer
- 1 filxhan çaji ujë -1 shkop kanellë, nëse preferoni.

Përgatitja  
Lani kumbullat, pritini në mes dhe hiqni bërthamat. Hidhni në një tenxhere me sheqerin dhe ujin e i lini për 2 orë. Më pas, shtoni edhe shkopin e kanellës, nëse dëshironi dhe e vini në zjarr për 12-15 minuta. Më pas hidhni në vazo qelqi. Pasi të mos jetë më e nxehtë, futeni në frigorifer. Mund t'i hidhni edhe më pak sheqer nëse preferoni. Lëngun mund ta konsumoni me akull më vete, ose së bashku me kumbullat.

### VLERAT PËR SHËNDETIN

Vlerat shëndetësore të kompostos variojnë kryesisht nga vlerat e mjaltit të shtuar dhe frutave të përzgjedhura. Zakonisht 280 gramë komposto kanë 344 kalori, 80 gramë karbohidrate, 2 gramë proteina dhe 9 gramë fibër. Shumica e këtyre vlerave ushqimore vijnë nga frutat dhe një pjesë tjetër nga mjalti apo ëmbësuesit e tjerë. Sipas të dhënave, konsumimi i të paktën 225 gramë karbohidrate dhe 50 gramë proteinë në ditë përshpejton riparimin e indeve dhe ofron energji. Me komposton konsumoni sasi të konsiderueshme të vitaminës A, 67 miligramë potas, kalcium, folat magnez, hekur dhe vitaminë C. Vitamina A është e këshillueshme për shëndetin e syve, lëkurës dhe kockave, por edhe për funksionimin normal të sistemit të frymë-marrjes. Ndërkohë, doza e rekomanduar ditore e kaliumit është 470 miligramë. Ai ul tensionin e gjakut dhe e mban sistemin imunitar të fortë.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës/ Zunë truallin pa leje, bëhen pronarë

Qeveria miratoi kalimin e të drejtës mbi pronësinë për parcelat ndërtimore ku janë ndërtuar objekte pa leje. Agjencia Shtetërore e Kadastrës publikon listën me 200 pronarë që marrin certifikatën e pronësisë. Përfuturit janë në Elbasan, Tiranë Veri, Tiranë Jug, Tiranë Shëtesat, Durrës, Vlorë dhe Shkodër. 'Gazeta Shqiptare' publikon listën e plotë me përfituesit në të gjithë vendin.

**VENDIMI**

Këshilli i Ministrave vendosi në mbledhjen e fundit miratimin e kalimit të së drejtës së pronësisë, në favor të subjekteve përfituese, për 200 parcela ndërtimore të objekteve të legalizuara, që preken prej tyre, sipas shprehjes që i bashkëlidhet këtij vendimi. Sipas ligjit në fuqi

# Tapi për 200 familje, ja kush përfiton truallin

Përfituesit në Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Lezhë e Vlorë

nuk mund të legalizohet më shumë se 3-fishi i bazës së objektit të ndërtuar pa leje. Në rast se një person ka ndërtuar 50m2 do të marrësh 150 metra dhe kjo logjikë do të ndiqet për të gjitha ndërtimet. Objektet tregtare që kanë bërë ndërtime p.sh., 500

metra do të marrin 1500 metra, por do ta paguajnë me çmim tregu. Ndërsa për llogaritjen e vlerës së parcelës është marrë gjysma e vlerës së tregut.

**KALIMI I PRONËSISË**

Në vendimin e Këshillit të Ministrave përcaktohet që

kalimi i së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të objektit pa leje bëhet sipas dispozitave të Kodit Civil. Në rastin e ndërtimeve me funksion banimi, si rregull sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë duhet të jetë deri

në masën e trefshit të bazës së ndërtimit, por në çdo rast jo më e madhe se 500 (pesëqind) m<sup>2</sup>. Për ndërtimet pa leje me funksion social-ekonomik zbatohet vetëm kriteri i trefshit të sipërfaqes së bazës së ndërtimit. Kur për shkak të përmasave

**LIGJI**

Sipas ligjit në fuqi nuk mund të legalizohet më shumë se 3-fishi i bazës së objektit të ndërtuar pa leje. Në rast se një person ka ndërtuar 50m2 do të marrësh 150 metra dhe kjo logjikë do të ndiqet për të gjitha ndërtimet.

ose konfiguracionit të parcelës ndërtimore krijohen sipërfaqe të lira, që nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, ato i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar						Ujenti a juridike (prones)
Emër	Atësi	Mbiem ër	Leja e legalizimit		TE	
			Numer	Date		
<b>TIRANE JUG</b>						
<b>QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8380</b>						
<b>KAMEZ-VORE</b>						
<b>QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE _2066</b>						
NAIM	MET	PASHA	70209326	20.02.2018	TE	TRETEVE E(500 m <sup>2</sup> )
<b>QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE _2884</b>						
NAZMI	RRAHMAN	HYSA	70209250	18.02.2018	TE	
<b>QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE _1649</b>						
IMER	HALIL	HALMUSA	70208286	27.07.2018	TRETEVE	E(500.5)
SAIMI	IMER	HALMUSA				
<b>QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE _1649</b>						
VEHA	MET	TODAJ	70202102	15.02.2016	TE	
<b>QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE _1066</b>						
SKEN	RIZA	SELITA	70208215	21.07.2018	TE	
<b>QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE _2884</b>						
ISUF	XHAFERR	POLES	20063	13.03.2012	TE	
<b>TIRANE SHËTESAT</b>						
<b>QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE _8260</b>						
JORGO	NDONI	PRIFTI	120392	26.07.2018		
NIKOL	MARK	NDOI	119116	16.06.2017		
FREDI	DEMIR	XHAFERAJ	119502	28.09.2017		
FASLLI	NJAZI	KORITA	120595	17.10.2018		
<b>QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE _8260</b>						
GELDON	GEZIM	TELA	118584	07.03.2017		
FREDERIK	PETRIKA	MUSHI	118677	27.03.2017		
HASIME	JONUZ	CELA	118676	27.03.2017		
ALBI	BESNIK	MUÇO				

Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar						Ujenti a juridike (prones)
Emër	Atësi	Mbiem ër	Leja e legalizimit		TE	
			Numer	Date		
<b>QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE _8160</b>						
LIRAK	MUNTAZ	KODRA	120052	25.04.2018		
EVA	YZEIR	SEJDIA	120127	22.05.2018		
BARIJE	MALIQ	NAJDENI				
KUJTIM	MERO	SHUSHOLLARI	120053	25.04.2018		
MEHMET	MEHMET	HAKCANI	120054	25.04.2018		
IFETE	SHYQYRI	HASIMJA	120055	25.04.2018		
FIQIRI	ALI	DUMI	120057	25.04.2018		
GAVRIL	THIMI	QIRJO	120056	25.04.2018		
KRIST	LLUKAN	DUSHI	119942	23.03.2018		
NAZMI	ALUSH	REXHEPI				
<b>QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE _8220</b>						
TAHIR	TAIP	KALEMAJ	119112	16.06.2017		
TAHIR	TAIP	KALEMAJ				
FANIJE	THOMA	HAMLLA	119007	23.05.2017		
LUTFIJE	MEHMET	KOÇI	119008	23.05.2017		
FATMIRE	MEHMET	SHETA	119006	23.05.2017		
FLAMUR	SULEJMAN	DEMNERI	119114	16.06.2017		
TEUTA	SULEJMAN	GASHI (DEMNERI)				
MERITA	SULEJMAN	FAGU (DEMNERI)				
FLAMUR	SULEJMAN	DEMNERI	119054	05.06.2017		
<b>VLORE</b>						
<b>QARKU Vlorë, ZONA KADASTRALE 2832, ZVRPP Vlorë</b>						
REIZ	MEZIN	KULL	212036	25.09.2018	Shtetëror	
DERVI	MEZIN	KULL	212034	25.09.2018	Shtetëror	
GURI	MEZIN	KULLURI	212035	25.09.2018	Shtetëror e (0)m <sup>2</sup> E te	
<b>QARKU Vlorë, ZONA KADASTRALE 8602, ZVRPP Vlorë</b>						
PATRIOT	SADIK	NURAJ	4983	16.02.2011	Shtetëror e (0)m <sup>2</sup> E te tretteve (440.7) m <sup>2</sup>	
<b>QARKU Vlorë, ZONA KADASTRALE 8605, ZVRPP Vlorë</b>						
RIZA	DEMIR	NANA	212207		Shtetëror e (0)m <sup>2</sup> E te tretteve (500) m <sup>2</sup>	
					Shtetëror e (0)m <sup>2</sup>	

Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar					Emëri i pronës (prones)
Emër	Atësi	Mbiemër	Leja e legalizimit		
			Numer	Date	
GURI	DEMIR	NANA	107478	21/10/2018 42951.00	Shtetëror e (0)m <sup>2</sup> E te treve (500) m <sup>2</sup>

**ELBASAN****QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 3422**

ARDJAN	MEHDI	KABASHI	2579886	31.08.2018	PRONAR
--------	-------	---------	---------	------------	--------

**QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 8527****LEZHE****QARKU LEZHE, ZVRPP LEZHE, ZONA KADASTRALE 8632**

JAK	NDUE	MARKU	816912	27.06.2016	E te
MONDI	JAK	MARKU	817941	26.08.2016	E te

**DURRES****QARKU DURRES, ZVRPP DURRES, ZONA KADASTRALE 3369**

EDMOND	ISLAM	ISAKU	223286	15.09.2016	PRONAR
ASTRIT	ISLAM	ISAKU	222656	06.09.2016	PRONAR
ARBE	KASEM	VORA	220020	12.07.2016	ME PRONAR
ISMET	KASEM	VORA			
BAJRA	KASEM	VORA			

**QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 8515, ZVRPP DURRES**

PERP	NAZIF	HOXHA	242039	26.05.2016	ME
BASH	NAZIF	HOXHA	147097	29.02.2016	ME
QAMIL	TAIP	SPANESH	147088	11.02.2016	ME
SAIMI	NAZIF	HOXHA	152600	16.02.2016	ME
SELA	NAZIF	HOXHA	147096	31.03.2017	ME

**QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 8517, ZVRPP DURRES**

NDRE	PRENG	CUMRA	280027	25.07.2018	
YLBER	VESEL	ALUSHI	144827	27.05.2016	
YLBER	VESEL	ALUSHI	144827	27.05.2016	

**SHKODER****QARKU SHKODER, ZONA KADASTRALE 1495, ZVRPP SHKODER**

BASHKI	OAZIM	ÇOBAJ	93194	31.11.2015	
ARIF	OAZIM	ÇOBAJ	92742	16.02.2015	

**QARKU SHKODER, ZONA KADASTRALE 8591, ZVRPP SHKODER**

HAKI	HASAN	FASLUJA	18770	30.06.2017	
HASAN	MUSA	RAMJA	18769	20.07.2016	

**QARKU SHKODER, ZONA KADASTRALE 8593, ZVRPP SHKODER**

FRANG	GJON	LEKAJ	10221	02.05.2012	
LAZE	KOL	GJEKAJ	10005	26.04.2012	
NDOC	NDUE	LEKAJ	11022	14.05.2012	
GJON	RAKE	DOÇAJ	19591	29.07.2016	
GJON	MARASH	KOLAJ	19583	13.10.2015	
KUJTIM	ZEF	VUKAJ	19584	27.12.2018	

**QARKU SHKODER, ZONA KADASTRALE 8597, ZVRPP SHKODER**

LULE	SOKOL	GJELAJ	94803	10.05.2016	
------	-------	--------	-------	------------	--

NDOC	KOLE	BJESHKA	102231	30.03.2018	
------	------	---------	--------	------------	--

Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar				
Emër	Atësi	Mbiemër	Leja e legalizimit	
			Numer	Date
1	2	3	4	5

**QARKU ELBASAN, ZVRPP GRAMSH, ZONA KADASTRALE 1842**

OSMAN	ZENEL	TAÇE	1020008	9.1.2017
MONDI	OSMAN	TAÇE		
LUAN	OSMAN	TAÇE		
OSMAN	ZENEL	TAÇE	792008	8.2.2017

SAIP	LAVE	BIBA	528428423	31.1.2018
------	------	------	-----------	-----------

**QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 8526**

NJAZI	MURA	MUSAI	28938	15.3.2013
-------	------	-------	-------	-----------

**QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 8526**

ZAIM	ZALO	NUHU	9997540	12.12.2015
MIDIL	QAZI	BIÇAKU	99632580	21.9.2015
SHPETIM	MIDIL	BIÇAKU	77965322	3.5.2016
ANDRI	MIDIL	BIÇAKU	778526	2.3.2016
SERVET	HYQIME	DAUTI	990660	6.12.2014
BESIM	OSMA	BALLA	1020680	18.11.2016

**QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 8527**

BEHAR	QAMIL	VLLAHI	9925688	15.4.2015
ALBER	QEMAL	VLLAHI	9931251	25.8.2015
SAMI	IBRAHIM	XHAFI	991703	8.1.2015
HAJDA	RUSTEM	BOZHIQI	9928944	24.4.2015
ASTRIT	ASLLAN	SHOTI		2010

SKENDER	SALI	DEDA	992848	20.3.2015
SHEFQET	ISMAIL	RAMA	991755	4.2.2015
AGM	JAHO	ÇEKOJA	2578794	17.4.2018
BASHKIM	YMER	BEQIRI	58987458	20.10.2017
JANI	BAJRAM	GJOCA	79406	11.3.2016

**QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 3976, ZVRPP TIRANE**

MERITA	HAMIT	ZEQIRAJ	730890	26.8.2015
FLORINA	HALIT	CAM	1230131	24.7.2018

**QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8170, ZVRPP TIRANE**

NAZMR	RAMAZAN	HIMA	122775	3.11.2017
BLEDAR	NAZMR	HIMA	721449	6.11.2015
MIKEL	NAZMR	HIMA		

**QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8180, ZVRPP TIRANE**

FERIK	XHEVAL	FERRA	19348	4.10.2012
-------	--------	-------	-------	-----------

**QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8210, ZVRPP TIRANE**

ARQILE	KICO	FERI	18354	15.11.2012
--------	------	------	-------	------------


Opinion *i* Ditës

# 1992, si u hoq ylli i kuq sovjetik nga flamuri kombëtar dhe stema shtetërore

Nga Kastriot Dervishi

(vijen nga faqja 1)

... e Kushtetutës së re, të shpallur me dekretin nr.24, datë 15.3.1946 në artikullin 94, u vendos: "Stema e shtetit të Republikës Popullore të Shqipërisë përfaqëson një fushë të pëstjellur me dy tufa kallinj gruri. Tufat me kallinj gruri janë lidhur në funt me kordhelë, ku është shkruar data 24 maj. Në mes të majave të kallinjve ka një yll të kuq me pesë cepa. Në mes të fushës ka një shqiponjë të zezë me dy krerë". Ky parim u ruajt edhe në Kushtetutën e vitit 1950 si dhe në atë të vitit 1976. Kushtetuta e miratuar me ligjin nr.5506, datë 28.12.1976, u shfuqizua me ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese". Pavarësisht se u shfuqizua Kushtetuta e vitit 1976, pjesa e yllit të kuq dhe stemës ngeli në fuqi, sepse dispozitat e reja nuk e parashikonin ndryshimin. Kjo sepse Partia e Punës nuk pranonte ndry-



shime. Në fundin e vitit 1990, gjithë vitin 1991 antikomunistët e Shqipërisë e kishin bërë fakt të kryer heqjen e yllit të kuq

komunist nga flamuri dhe vende të tjera. Kjo gjë duhej bërë edhe juridikisht. Në mënyrë paradoksale, brenda sallës së Kuvendit

Popullor qëndronte një stemë e madhe e shtetit me yllin e kuq dhe 24 majin, e cila nuk kish qenë aty as në kohën e diktat-

urës. Pas zgjedhjeve të datës 22.3.1992, më 4.4.1991 çeli punimet Kuvendi Popullor. Meqë nuk ishte përfshirë në dispozitat e reja, u miratua një ligj i posaçëm. Shumica, Partia Demokratike, kërkoi ndryshimin e stemës dhe heqjen e yllit të kuq komunist nga flamuri në mbledhjen e datës 7.4.1992. Kësisoj, u miratua ligji nr.7558 "Për flamurin, stemën, himnin kombëtar, festën kombëtare dhe kryeqytetin e Republikës së Shqipërisë", i përbërë nga 7 nene. Ligji vendosi heqjen nga flamuri dhe kapela ushtarake e yllit të kuq, si dhe heqjen nga përdorimi të stemës së vjetër të shtetit, edhe kjo model jugosllav, me 24 majin 1944 në të. Në mënyrë paradoksale, megjithëse Shqipëria nga viti 1991 kishte hyrë në një rend të ri, ylli i kuq dhe stema e shtetit vijonin të ishin të pranishme. Pas miratimit të ligjit në fjalë, në periudhën prill-shtator 1992 ushtarakët nuk kishin asnjë lloj simboli në kapelat e tyre.

Marrë nga '55'

Letër e Hapur

## Letër e hapur zotit Sabri Laçi, dekan i Fakultetit Filologjik, Tiranë

Z. Laçi, dija nuk do mik, por do hapësirë mendimi, ku shprehja e fjalës në mënyrë akademike i jep të kuptuar kujt do që e referon, aftësinë e referuesit. Zoti Laçi, këtë letër po jua bëj të hapur për të vetmen arsye, pasi mediokriteti në katedrën e Historisë, ku shpjegohen format e besimit është në një nivel tjetër shpjegimi, sa që një ballafaqim ku dija përplasat me injorancën, kuptohet fare mirë roli i injorancës në katedrën bunker të Historisë. Nuk ka në botë asnjë lloj katedre, ku të mos ketë të varur në mure një tabelë datike historike, ku studentët në formimin e tyre t'i referohen kësaj tabele. Kjo tabelë mungon në katedrën e Historisë për arsyen e vetme të boshllëkut bunkerizues, që ekziston në këtë katedër. Që katedra të kishte një mendim hapësirë akademike, ku të referohej nga shumë personazhe të fakultetit dhe jashtë tij, unë i kam bërë kërkesë katedrës jo një herë, por shumë herë që të organizojë këtë diskuturë akademike për përmirësimin e nivelit në këtë fakultet. Por, gjithmonë bunkerit i injorancës nuk lejon zhvillimin e një diskursi akademik të fjalës së lirë, por shqyr që studentët e shembën murin e bunkerit dhe sot

nuk ka pedagogë që të mbahet dhe të shpjegojë lëndën në nivel injorance. Për këtë arsye po jua kërkoj publikisht juve, zoti Laçi, që më dukeni mendjehapur që të merrni përsipër organizimin e fjalës së lirë kundër injorancës. Në këtë ballafaqim, 50% duhet të jenë studentët ekselencës dhe 50% duhet të jenë pedagogët me integritet akademik dhe moral, ku brenda tyre vegjetojnë edhe doktoraturat false. I gjithë ky diskur duhet të zhvillohet përpara kamerave të televizione publike që populli, që i përket inteligjencës, ta kuptojë se kush e meriton që të qëndrojë në fakultet e kush jo. Kjo letër publike është në interesin e përbashkët të djes, e cila siç jua thashë në fillim, nuk do mik, por do hapësirë komunikuese. Që të ecësh me kohën, zoti Laçi, duhet të shpejtosh për marrjen e vendimeve për të mirën e përbashkët. Për më tepër, sqarimet për zhvillimet e konferencës ose diskutimeve mund të më thërrisni, pasi jam i vetmi historian, i cili në shpjegimin e formave



të besimit i shpjegojë në 3D, historik, shkencor dhe filozofik. Për arsye të vendosjes së tabelave datike, punimi im i përket edhe formatit enciklopedik. Për të qenë sa më korrekt me pedagogët që kanë integritet akademik dhe moral, më duhet t'ju them se kjo letër i drejtohet inteligjencës së moralshme, e cila kursesi s'do të pranonë që krahas saj të rreshtojë falsiteti i injorancës. Prandaj, ditën e fjalës së lirë dhe akademikët që janë kundër bunkerit të injorancës do të ishte më e ndjen veten me integritet dhe moral akademik të jetë pjesëmarrës në këtë diskuturë të lirë fjale, ku rolin kryesor e ka meritokracia. Besoj se zoti Laçi nuk do të vonojë në marrjen e vendimit për organizimin e meritokracisë kundër bunkerit të injorancës.

Me respekt, Edmond Vrapit, autor i Historisë së Lindjes së Religjioneve (Format enciklopedik)

Opinioni **i** Ditës

# Protesta dhe policët e plagosur

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... me më shumë efekte protestën time. Që revolta të ketë më tepër peshë. Është e drejta ime e shenjtë si qytetar në një demokraci. Do protestoj për kapjen e shtetit, për mungesën e vendeve të reja të punës. Për mbytjen e shpresës se ky vend bëhet. Për rilindjen e kthyer në vaditëse lulësh dhe ujitëse pemësh në qendra qytetesh të vogla, me urgjenca spitalore në ditë të hallit. Për korrupsionin e ngritur në sistem, në administratën shtetërore. Për tenderat shtetërore të celnikosur në vetëm disa radhë kompanish dhe studiosh projektimi shokë e miq të pushtetarëve të sotëm. Ku sipërmarrësi i thjeshtë, specialisti ose njeriu me ide biznesi e ndjen veten me vjetëritë larg parasë publike, nga ky klientelizëm i pashoq i krijuar. Për të rinjtë e arsimuar jashtë shtetit, që tallen nga drejtorucët e administratës sonë kur aplikojnë me forcën e dijeve dhe diplomave të universiteteve me emër ku kanë studiuar. Për mijëra ish-punonjës të shtetit që kanë qenë të detyruar të "hapin krahun" nga horri apo horra drejtorë që i ka hequr pa asnjë motiv të vlefshëm, madje edhe pa justifikim formal, duke futur të tjerë në vendin e tyre, militantë apo pagatorë nën dorë, duke i thënë paturpësisht: "Më hidh në gjyq po deshe!". Për të gjitha shushunjat e administratës, që marrin 20 për qind për t'u kthyer pronarëve një përqindje mjerane në formë parash, për



tokën e grabitur padrejtesisht, apo 10 për qind për rimbursimin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH). Për të gjithë horrat dhe horret e mjekësisë publike, për recetën elektronike, të paraqitur me aq pompozitet në nëntor 2017, por që sot nuk arrijn të kufizojë korrupsionin dhe abuzimin me tregun gjigant të barnave të rimbursueshme nga buxheti i shtetit. Për 83 milionë euro në vit (mbi 10 miliardë lekë) që paguhen nga taksat tona nëpërmjet Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor dhe ku receta elektronike nuk bën dritë as në një të njëzetën e këtyre parave tona (pjesa e madhe e ilaçeve të rimbursueshme tregtohen nga farmacitë, pa recetë elektronike dhe pa nën-

shkrim elektronik të mjekut). Për spitalet shtetërore, ku shteti shpenzon për çdo pacient të shtruar 180 mijë lekë të reja në muaj dhe pacienti merr vetëm një të dhjetën e kësaj shume në shërbime. Për strategjinë antikorrupsion, të nisur po me pompë e bujë në vitin 2015, por që ka përfunduar në tallje për qytetarët e këtij vendi, me cekëtinë e mosprimeve ku është zhytur. Duke shpenzuar kot 2 miliardë lekë të reja në tre vjet, pasi ka ngelur jetime, pse qytetari që ka humbur besimin të shteti nuk i denoncon rastet korruptive. Për një ngrëhinë me emër të madh: strategji ndërsëktoriale antikorrupsion, që ka katandisur pa mekanizim real mbikëqyrës. Për sportelet "One Stop Shop" që du-

hej të hapeshin pikërisht për të luftuar korrupsionin me paratë e donatorëve dhe janë hapur formalisht vetëm në 14 bashki. Duke u tallur me përmbyshjen e një prej pesë përparësive (detyrave të shtëpisë) për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Kjo është tabloja e sotme e administratës sonë shtetërore dhe jam gati të dal të protestoj për ta ndryshuar atë çdo ditë e natë. Por jo për të përdorur lëndë zjarrëzuese. Jo për të sulmuar në të errët Kuvendin me më shumë njerëz me maska se sa fytyra njerëzish të indinjuar dhe revoltuar. Jo për të plagosur policët e paguar keq të vendit tim, që mbrojnë institucionet e të gjithëve. Këtu ndahem nga opozita e sotme e rrugës. E dua opozitën jo piroteknike, por për të më dhënë shpresë. Shpresë se gjërat do të përmirësohen me ofertën e saj për të qeverisur. Shpresë që ta votoj opozitën, nëse bindem për programin e saj rimëkëmbës dhe sjellës të shpresës. Nuk dua falanga sulmi mbi institucionet. Nuk është kjo zgjidhje për problemet e mija si qytetar dhe të të dy milionë e gjashtëqind mijë banorëve të tanishëm të Shqipërisë. Kështu nuk i mbajmë dot njerëzit të mos braktisin vendin tonë. Kështu vetëm se shkatërron një gjë të vyer: shansin për opozitë konstruktive, që sot po bëhet vetëm nga dy deputetë të PD-së, që patën guximin t'i thonë 'jo' vetëshkatërrimit. T'i hyjnë detit me këmbë dhe të kërkojnë kryerjen e reformës zgjedhore, që do t'i japë më në fund moral dhe së ardhme politikës sonë, deri tani tërësisht të papërgjegjshme nga të dyja anët.

## HOROSKOPI

### DASHI

Do të ndiheni të mbushur plot energji gjatë ditës së sotme. Kjo u referohet veçanërisht personave të përfshirë në biznes. Sa i përket marrëdhënies së dashurisë, mos ustroni presion. Bëni durim dhe lejoni partnerin/partneren tuaj të vendosë vetë.

### DEMI

Disa Demë do të karakterizohen nga një sjellje e paeqilibruar, por përqipimi ta shmangni sa më shumë atë. Kjo nuk do të jetë aspak fitimprurëse, nëse po zhvilloni negociata në biznes. Mbroni veten nga personat që iu kanë zili. Mos dëgjoni këshillat apo kritikë të tyre.

### BINJAKET

Të lindurit e kësaj shenje mund të zhyten në mendime. Do të dëshironit që gjenit një zgjidhje të menjhershme për problemet tuaja, por mund të mos ndodhë kështu. Mos refuzoni këshillat e personave të afërt. Në mbërmje do të jeni pjesë e një eventi, që do t'ju bëjë të ndiheni mjaft mirë.

### GAFORJA

Ëndrrat tuaja në lidhje me paratë mund të bëhen realitet, nëse kapni në kohë shansin. Yjet ju këshillojnë që të tregoheni më aktivë dhe të dëshmoni se ju vleni më shumë nga sa të tjerët mendojnë. Në përgjithësi, bisedat e hapura me persona jo të ngushtë nuk janë të mirëpritura.

### LUANI

Luanët mund të harrojnë problemet me të cilat po përballen, pasi dikush pranë jush do t'ju bëjë të ndiheni të lumtur. Sa i përket marrëdhënies së dashuri, do të ndiheni të pafuqishëm. Ka gjasa të ndodhë një vendim të rëndësishëm lidhur me këtë.

### VIRGJERESHA

Të lindurit e kësaj shenje nuk rekomandohen të detyrojnë të vejë. Besimi në vetveten do t'ju ndihmojë të arrini fitore si në aspektin personal, ashtu edhe në atë profesional. Është shumë e rëndësishme të jeni optimistë, të komunikoni qetësisht dhe të respektoni ata që janë më të dobët.

### PESHORJA

Shumë Peshore do të fokusohen te çështjet personale. Ka gjasa të rriteni në detyrë. Sa i përket ndjenjave, nuk do të keni shumë fat sht. Bëni kujdes nga disa persona rreth jush! Do të ishte e udhës t'i ndani fitoret vetëm me familjarët dhe miqtë e ngushtë.

### AKREPI

Nëse prisni të pasuroheni në kohë rekord, mos harroni ligjet dhe moralin. Ka gjasa të eksperimentoni në fushën e ndjenjave. Ata që janë në një lidhje të fortë dashurisë, duhet ta respektojnë atë. Kënaqeni partnerin/partneren tuaj duke e befusuar me një dhuratë.

### SHIGJETARI

Kjo ditë do t'ju kalojë sikur të ishte një moment i vetëm. Parashikohen një sërë problemesh në lidhje me familjen apo karrierën. Biznesmenët duhet të bëjnë kujdes nga sulmet e konkurrentëve.

### BRICJAPI

Bricjapët do të jenë të pakënaqur me rezultatin e kësaj dite. Parashikohen probleme në aspektin profesional. Ka gjasa t'ju dëshpërojë një projekt për të cilin keni kohë që punoni. Rekomandohet të bëni joga, pasi do t'ju ndihmojë të qetësoheni emocionalisht.

### UJORI

Ujorëve do t'ju duhet t'i përgjigjen një pyetjeje mjaft të vështirë. Ka gjasa të merrni një vendim të rëndësishëm. Mund të ndryshoni profesion ose të vendosni për një tjetër hap në lidhjen tuaj të dashurisë. Kur të merrni një vendim të tillë, konsultoheni me dikë që keni shumë besim.

### PESHQIT

Kjo ditë për Peshqit mund të jetë pikënisja e diçkaje të madhe. Mund të kërkonit për një vend pune me më shumë të ardhura, ose të nisni të përmirësoni marrëdhëniet familjare. Përqipimi të jeni sa më energjikë dhe të mbështesni të tjerët.

Opinioni **i** Ditës

"Zëri i Amerikës"

Një mur në ishullin Ellis të Nju Jorkut që nderon emigrantët është i mbuluar krejtësisht me emra. Deri më sot, 770 panele janë ngritur duke mbartur emrat e mbi 800 mijë emigrantëve. Siç njofton korrespondenti i "Zërit të Amerikës", Ramon Taylor, aty janë shkruar edhe emrat e emigrantëve që kanë mbërritur rishtazi. Shumica e emigrantëve të përjetësuar në Murin e Nderit të Emigrantit Amerikan mbërritën në ishullin Ellis rreth një shekull më parë, pas një udhëtimi të gjatë nga Evropa. Por, edhe pas mbylles së kësaj qendre pranimit në vitin 1954, anëtarët e familjeve nga Amerika Qendrore dhe Azia Juglindore mund t'i gjejnë emrat e tyre të gdhendur në pllakat e çelikut. "Të gjithë duan të nderohen. Duan të kujtohen. Duan që momenti i mbërritjes së tyre në Amerikë të përjetësohet. Kjo është ajo që përqipimi të realizojmë

# Nju Jork, muri që nderon emigrantët

këtu", thotë Stephen Briganti, presidenti i Fondacionit të Statujës së Lirisë dhe Ishullit Ellis. Diversiteti i emrave sot reflekton tendencat e vendit që po ndryshon. Projekti filloi në vitin 1987, me synim ngritjen e fondëve për restaurimin dhe mirëmbajtjen e ishullit Ellis. Tashmë ai përmban 775 mijë emra të skalitur në 770 panele të vendosura përballë Statujës së Lirisë dhe Manhatanit. Për 150 dollarë, çdo emigrant apo pasardhësit e tyre mund të shtojnë këtu emrin e familjes së tyre. Ndërsa viziton murin që nderon stërgjyshërit e saj, Erin Josen thotë se vështirësitë e emigrantëve të mëhershëm duhet t'u japin shpresë të ardhurë rishtazi. "Nëse do të

isha një amerikane e brezit të parë apo të dytë, do të mahnitesha se si këta njerëz u mbijetuan të gjitha kundërshtive dhe vështirësi; i kontrolluan, i gjykuan, u thanë që nuk ju duam këtu. E megjithatë, ata arritën të ngrenë familjet e tyre dhe të lënë pasardhës të brezit të tretë, të katërt dhe të pestë", thotë Erin Josen, pasardhëse emigrantësh të mbërritur në ishullin Ellis. Turistët e huaj mrekullohen me diversitetin e Muzeut Kombëtar të Emigracionit në ishullin Ellis, edhe kur nuk kanë emrat e familjeve të tyre këtu. "Është mirë që çdo gjë është e dokumentuar, që i kanë mbajtur shënim të gjithë këta emra. Amerikanët mund të rizb-

ulojnë këtu paraardhësit dhe rrënjët e tyre", thotë Celine Uhart, turiste franceze. Sipas fondacionit, në këto panele ka përfaqësues nga të gjitha kombësitë. Madje, këtu përfaqësohen edhe skilleverit që u zollën me forcë. "Rrëfëjmë historinë e skilleverëve dhe mbërritjen e tyre. Ishte një situatë e tmerrshme, një tragjedi e tmerrshme. Por, ata janë tashmë pjesë e Amerikës, e historisë së saj dhe e asaj çfarë Amerika është tani. Duhet t'i nderojnë edhe ata familjet e tyre, ashtu si të gjithë të tjerët", thotë zoti Briganti. Në këtu mur kanë zgjedhur të nderojnë familjet e tyre edhe pjesëtarë të popullsisë indigjene të indianëve të Amerikës.

**Bardheblutë thyejnë Teutën**

**Tirana largon frikën në Durrës, fitore me aromë mbijetese**

Futbolli është shumë i çuditshëm, aq më tepër ai shqiptar. Tirana nuk fiton kur duhet, por fiton pikërisht aty ku dukej e vështirë, për të mos thënë e pamundur. Pas gjashtë ndeshjeve pa fitore, përjashto këtu 3-pikëshin në tavolinë përballë Kamzës, bardheblutë fitojnë në një transfertë të vështirë si ajo e Teutës, për më tepër në momentin kur durrsakët kërkonin me qdo kusht fitoren për të mos larguar



nga zona euro. Kjo isha e diela perfekte për kryeqytetasit, që jo vetëm fitojnë në transfertë, por marrin një 'dhuratë' shumë të madhe nga Skënderbeu, me korçarët që çmontu-

an Kastriotin me një poker golash, një kombinim perfekt që e largon Tiranën me 6 pikë nga zona e ftohtë, ndërsa i ushtron presion nga pranë Luftëtarit. Të dy trajnerët zbriten në fushë me shumë ndryshime, mbi të gjitha Shkëmbi, i cili ashtu siç kishte paralaj-

jmëruar, la në stol një pjesë të senatorëve si Hidi apo Arapi, por as këto lëvizje nuk i ndryshuan fatet e Teutës, pasi Oduamadi me një sprint të jashtëzakonshëm në minutën e 42-të nxori në pah të gjitha problemet e prapavijës durrsake, duke e kaluar Ti-

ranën në avantazh. Si gjithnjë Teuta e nis keq, përpiqet të rifutet në lojë, krijon raste për shënim, por janë të pasaktë në pasin final dhe mbi të gjitha në finalizim. Është e çuditshme se me sa lehtësi Teuta pëson edhe golin e dytë, Kobina dhe Edon Hsani ko-

mbinojnë në mënyrë perfekte ndërmjet tyre me shkoderanin, që shënon dhe golin e dytë për bardheblutë. Teuta rikthehet në lojë me një gol shumë të bukur nga Kamara në minutën e 73-të, por festa e bregdetarëve zgjati shumë pak. Erando Karabeci me një goditje të thatë nga jashtë zonë shënon edhe golin e tretë për Tiranën, duke hipotekuar këtë trepikësh jetik. Nga pretendete për titull, Teuta e sheh vetëm tashmë edhe jashtë Europë.

Partizani shkon në 12 pikë avantazh, Gjoka pranon betejën vetëm për vendin e dytë

**Ekipi i Flamurtarit shuan shpresat e Kukësit për titull**

*Në "Elbasan Arena" triumfojnë vlonjatët 1-2*



Jeton Selimi

Dy perla vlonjate, dy gola për të thyer Kukësin dhe për të festuar si gjithnjë në mënyrë unike. Motivi këtë herë ndryshon, pasi festa apo mesazhi është i qartë "leku letër". Flamurtari feston një ditë përpara premtimit të administratorit Idrizi, i cili theksoi se të hënën do të shpërndajë rrogat, mbase ky ishte një motiv ekstra për të dhuruar një tjetër paraqitje fantastike, më saktë arritën një rezultat fantastik, një fitore 1-2 në transfertë kundër Kukësit ka gjithnjë një shije të veçantë. Ekipi i Ilir Dajës zgjohet pikërisht në momentin më përcaktues të sezonit, 3 fitore në 3 ndeshjet e fundit kanë bërë që kuqezinjtë të blindojë vendin e tretë. Jo vetëm kaq, por tashmë i



SUPERLIGA		
JAVA E 29-të		
Luftëtari - Laçi	1-0	
Kukësi - Flamurtari	1-2	
Skënderbeu - Kastrioti	4-0	
Teuta - Tirana	1-3	
Partizani - Kamza	3-0	
Renditja		
Skuadra	N	P
Partizani	29	60
Kukësi	29	48
Flamurtari	29	47
Skënderbeu	29	43
Teuta	29	43
Laçi	29	41
Luftëtari	29	37
Tirana	29	36
Kastrioti	29	30
Kamza	29	17

ushtrorj presion nga pranë Kukësit, diferenca është vetëm një pikë. Ajo që ka bërë Flamurtari këtë sezon është një model frymëzimi, tetë muaj pa u paguar dhe me një ekip thuajse të shpërbërë pas merkatos së janarit, e të jesh në këtë nivele është diçka që nuk ndodh shpesh në futbollin shqiptar. Ilir Daja besoi deri në fund, tani është momenti i duhur për të shpërblyer këtë ekip, të paktën të marrin atë që i takon. Kukësi lan sërish duart me titullin, ajo fitore kundër Laçit ishte thjeshtë një mirazh, sepse jo vetëm që nuk arritën të zvogëlonin diferencën me Partizanin, por tashmë e shohin 12 'kate' larg. Titulli tashmë thjesht një kujtim i larg për verilindorët. Në një sfidë ku Kukësi ishte dominues në çdo aspekt, ku për 30 minuta zhvilloi një presion asfiksues në zonën e Koliqit, ai që bëri diferencën ishte një "xhevahir" si Sukaj. Sulmuesi shkoderan shtrin Cuculin në minutën e 39-të, duke kaluar Flamurtarin në avantazh. E njëjta muzikë edhe në pjesën e dytë, Kukësi ka kontrollin e lojës, por ekipi i Ernest Gjokës çahet pikërisht në zemër të mbrojtës, në minutën e 49-të ai që bën fenomenin në zonë ishte Musta. Verilindorët u rikthyen në lojë në minutën e 69-të me një aksion model, Shkurtaaj shërbeu në zonë për Rexhinaldon, i cili ngushtoi diferencat në 2-1, një gol që shërbeu vetëm për suspancë, pasi asgjë nuk ndryshoi deri në fund, Kukësi bie sërish.

**Vllaznia siguron rikthimin në Superligë**

**Canaj, modest: Merita është e Hasan Likës**

Vllaznia ka mundur pasditen e djeshme Erzenin në transfertë me rezultatin 0-3. Golat janë shënuar nga Zhunior, Tafili dhe Zeqja. Tashmë shkoderanët e kanë siguruar edhe matematikisht ngjitjen në elitë. Pas sfidës, para mediave ka folur Agim Canaj, trajneri i Vllaznisë. Canaj në fjalën e tij ka falënderuar së pari Likën, i cili ka lënë një skuadër të gatshme për ngjitjen në Superiore. "Padyshim jam mjaft i kënaqur nga fitorja, por me këtë rast dua të komplimentoj punën e kolegut Hasan Lika gjatë gjithë kampionatit, i cili



u largua për arsye personale dhe më la në dorë një ekip të përgatitur për të rihyrë në Superiore. Gjithsesi, ne do të luftojmë gjatë gjithë kampionatit për të

bërë lojëra sa më me dinjitet dhe natyrisht të përgatitimi në të ardhmen për një konkurrim sa më cilësor në Ligën Superiore", është shprehur Canaj.


**SERIA A**

**Hysaj i paprekshëm, Napoli dërgon Kievon në Serinë B**

Pas një eksperiencë të tmerrshme kundër Arsenalit, Napoli dhe Hysaj shfryjnë dufin kundër Kievos, duke i zbritur matematikisht në Serinë B. Nuk arriti t'i rivalizonte për titull, por Napoli i shtyn festën "Zonjës së Vjetër", të paktën edhe me një javë. Njeriu i ndeshjes për napolitanët ishte Kulibali, autori i një dygolëshi në minutën e 15-të dhe në të 81-tën, Milik komplettoi "tripleletën" e golave. Goli i Sezar në minutën e 90-të ishte thjesht për statistikë. Pavarësisht se dështoi kundër "topçinjve" në Europa League, Anceloti i besoi sërish një fanellë titullari Hysajt, madje as në pozicionin e tij natyral, pasi anësori i Kombëtares me shumë luajtje në qendër se sa në krah. Këtë e bën pa shumë sforco, sigurisht sulmi i Kievos nuk është i papërmbajtshëm.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- Mund të jetë kursimi.
- Ylli i Nostradamus.
- Tamam pa kufij.
- Ross këngëtare.
- I lashtë.
- Eshhtë Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
- Kufijtë e lëvizjes
- I ka tek plepi.
- Paguhen për shërbim.
- Fillojnë lejen.
- Kufizojnë trotuarët.
- Bëjnë karrierë në parti.
- Thahet me bonifikim.
- Mund të jetë unik një i tillë.
- Preka komik shkordran.
- Fund dhjetori.
- Fillojnë aksionin.
- Ente Operative Tiranë

- Agjenci Ajrore Durrës.
- Një pjesë e dimensioneve.
- Eshhtë përfaqësuesja e Adriam Mutu.
- Kalimi në ekstreme.
- Eshhtë e re pas Krishtit.
- Shkruhet për të mos vazhduar më.
- Si i gjithë
- Kush e thotë lutet.
- Kufij elementit.
- Ishtë nrya që preu Aleksandri i Madh.
- Një pjesë e titanëve.
- Mund të jetë kundërmuese.
- Pak titanike.

**VERTIKAL**

- Si i përshtatëshëm.
- Mund të jenë fetare.
- Ai i kuq e ka një huq.
- Pak analogji.
- Eshhtë metri i roboqepësist.
- Në hyrje të oazit.
- Arte pa re.
- Arthur që qe dramaturg.
- Janë boshste.
- Michelangelo regjisor.
- Mund të bëjë stil të lirë.
- Ishin monedhe të Tobias.
- Eshhtë bas me katër tela.
- Pak efikasitet.
- Eshhtë marrëveshje me nota.
- Ishtë babai i Akilit.
- Fillojnë nazet.
- Në krye të kuadrove.
- Eshhtë faqe muri.
- Një apendisit i menjëhershëm.
- Kurosawa që qe regjisor.
- Vriten nga espada.
- Eshhtë shtet aziatik.
- Edouard piktor.
- Një transporti është kamioni.
- Uni i Freud.
- Një cigan.
- Fundi i një samuraj.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


- Fillojnë panikun.
- Gibson aktor.
- Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
- Mund të jetë trofe.
- Janë vendet si Katari
- Maureen që qe aktore.
- Janë kundërmuese.
- Mund të fitojnë etapa.
- Ushtojnë nga "ola".
- Një thirrje
- Janë ministritë.
- Një rrugë në Paris.
- Markë cigareje.
- Eshhtë ngjinja.
- Ricciarelli soprano.
- Fillojnë sefte.

**VERTIKAL**


- Një votë në favor.
- Filozofi me eksperimentin e gomarit.
- Në hyrje makinës.
- Fillojnë lehtë.
- Irlanda në Dublin.
- Eshhtë edhe ajo e historisë.
- Një pjesë e gamiljeve
- Notat pa kufij.
- Ishin komitë.
- Ka kryeqytet Islamabad.
- Don... i Interpretuar nga Terence
- Mbyllin aktet.
- Janë përmasa.
- Gjysma e lutjes.
- Castellitto aktor.
- Inicilat e Dalí, piktor.
- Tanita këngëtare.
- Eshhtë trysni
- Në hyrje të Europës.
- Janë rrobat për t'u larë.
- Bën mëza.
- Moreau aktore.
- Janë thika.
- Një pjesë e satelitit.
- Janë teke në sende.
- Pak marramendëse.
- I ka tek zdapi.
- Iniciale e Nolte-s.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQVE TË NUMRIT TË KALUAR**

S	H	A	K	A	X	H	I	P	O	K	E	R
P	A	T	R	C	I	A	K	I	N	I	N	A
A	R	I	A	E	F	O	R	M	I	T		
A	K	V	I	K	T	I	M	A	T	G		
K	M	A	R	R	E	Z	I	T	E	M	P	
M	E	T	E	O	R	I	T	E	T	A	O	
R	O	M	A	N	T	I	K	E	T	A	T	L
E	T	O	E	A	T	T	M	R	O			
P	O	R	T	L	A	T	I	N	M	U	N	
A	R	E	O	L	E	O	R	A	R	I		
R	E	A	L	E	T	I	R	A	N	I		
T	T	I	L	E	S	M	E	R	A	L	D	A

**FJALËKRYQI (1)**

K	A	N	T	T	E	H	U	A	S	I	A	
E	R	O	K	H	A	R	T	A	T	F		
R	A	T	O	M	R	A	O	A	V	A		
C	M	E	L	E	M	E	N	T	E	T		
T	M	E	K	O	N	O	M	I	A	T	R	I
M	A	K	A	D	A	N	E	L	E	K	U	
O	G	O	A	K	S	I	L	I	R	I		
B	A	R	R	A	A	T	O	L	I	N		
A	R	I	E	L	K	R	E	R	E	T	S	
M	A	T	B	A	L	E	R	I	N	A	T	S
A	T	I	L	A	A	S	S	I	T	A	R	

**FJALËKRYQI (2)**

**SUDOKU**

	6		8		1			
		3	5					
4	1	7						
8					6			
9					3			
3				7				
			3	7				
	5	8						4
8	1	6						

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

7	4	1	3	5	8	2	9	6
9	2	8	4	1	6	3	7	5
3	5	6	9	7	2	8	4	1
5	6	4	1	2	9	7	8	3
2	3	9	7	8	5	6	1	4
1	8	7	6	3	4	9	5	2
8	1	3	2	4	7	5	6	9
4	9	5	8	6	3	1	2	7
6	7	2	5	9	1	4	3	8

**Argëtim filozofik**

- Njerëzit gjejnë kohë për ata që duan të gjejnë. Njerëzit u shkruajnë dhe u përgjigjen atyre që duan tu flasim. Mos i besoni kurrë dikujt që thotë se ka qënë tepër i zënë. Nëse do të dëshironin të ishin aty me ty, do të ishin patjetër !!  
- Mos lejoni të dëshmen të shpenzojë kaq shumë nga e sotmja.  
- Kushdo që nuk mund të kuptojë heshjen tuaj, nuk mund të kuptojë as fjalët tuaja.



**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

3	1	7	2	7	3	13	2			K	A	N	A	P	E	G	R	A	D	E	T										
2	7	5		8	4	3	5	7	2	6											T	E	D	I							
7		3	1	9	1	6	5	10	6	2	6										N	T	L	K	A	P	E	L	E	T	
		3	5	8	2	3	5	6	1	7	5										H	E	T	I	M	O	R	E	T	N	U
12	5	13	5	10	1	7		6													D	E	E	K	O	N	O	M	I	A	L
2	7	18		5	11	2	6	5	8	2	6										I	B	L	A	K	I	M	E	T	K	L
8	2	6	2	2	2	1	8	5	11	1											A	R	I	A	N	A	A	T	A	A	I
1	6	8		17	9	5	7	2		9											M	E	N	E	S	T	L	A	T		
3	1	5		8	2	16		2	7	1											A	U	A	I	I	L	I	R	E	T	
2			3	2	6	5	9	2		1	13										N	B	A	N	A	K	A	E	T		
6	2	7	2			3		K	19	3	M	6	T								T	E	E	M	A	K	E	T	N	E	T
3	4	8	5	19	1	5		3	5	2											I	D	R	I	T	A	I	D	E	T	E

**Thënie të mençura**

- Eshhtë normale, të gjithë bëhen filozofë kur nuk është problemi i tyre.
- Mos prisni askënd në jetën tuaj ...
- shkoni përpara ... dhe ata që duan, do t'ju arinin !!!
- ...Dhe vjen një ditë kur ti e kupton se "çdo gjë" ishte "asgjë" .... vetëm një zhgënjim !!!
- Çdo herë që përpigëm të ndryshoj ... përfundoj të jem vetvetja!!!

